REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BERAT

RAPORTI I PERGJITHSHEM TEKNIK

*PROJEKTI :*NDERTIMI I GODINES SE PARKIMIT DHE HAPESIRAVE MBESHTETESE NE BERAT

BASHKIA BERAT

Tirane, 2020

Permbajtja

1.1- INFROMACIONE TE PERGJITHSHME

1.2 - QYTETI I BERATIT

1.3- PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR

1.4-VENDODHJA E SHESHIT

1.5-QELLIMI I PERGJITHSHEM

1.6-GJENDJA EKZISTUESE

1.7- KONCEPT IDEJA

1.8- PROJEKTI ARKITEKTONIK

1.1- INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

Shqiperia ndodhet ne Europen Juglindore dhe ka nje siperfaqe prej 28.748km^2. Kufizohet me Malin e Zi dhe Kosoven ne veri, IshRepubliken Jugosllave te Maqedonise ne lindje, dhe Greqine ne jug. Shqiperia shtrihet ne bregdetin lindor te detitAdriatik.

Gjatesia e pergjithshme e kufirit te Shqiperise eshte 1.094 km. Kufijte tokesore, detare, liqenore dhe lumore jane perkatesisht: 657 km, 316 km, 73 km dhe 48 km. Vija bregdetare eshte427kmegjate:273kmiperkasinbregdetitteAdriatikutdhe 154 km bregdetit teJonit.

Bazuar ne te dhenat e Rregjistrimit te Popullsise ne vitin 2011, rezulton se popullsia e Shqiperise eshte 2,895,947 banore.

Terreni qe pershkruan Shqiperine eshte70% terren malor dhe pjesa tjeter fushor, kodrinore bregdetar. Rajonet bregdetare kane klime te bute,por me ne brendesi dhe ne veri, klima karakterizohet nga dimer i ftohte dhe vere me reshje te konsiderueshme.

Ne Shqiperi funksionojne disa modalitete te transportit si :

- **Transporti ajror civilnderkombetar**
- **Transportihekurudhor**
- **Transportidetar**

Rrjeti kombetar rrugor perbehet nga:

1.2 - QYTETI I BERATIT

Berati është qytet me rreth 65.000 banorë dhe njëra nga dy bashkitë e Rrethit të Beratit që bën pjesë në Qarkun e Beratit .Trojet e Beratit, sipas arkeologëve kanë qenë të banuara nga njerëz të civilizuar që nga shekulli VII para erës sonë. Rrethi Berat është i perbere prej 2 bashki e 10 komuna. Qyteti i Beratit është ngritur fillimisht si kështjellë, mbi kodrën shkëmbore me lartësi 187m mbi nivelin e detit, në krahun e djathtë të lumit Osum,para sekytëdalënëfushëneMyzeqesë,mëemadhjaeShqipërisë.Rrethi i Beratit shtrihet në Krahinën Malore Qendrore e pjesërisht në Ultësirën Jugperëndimore të Shqipërisë, në koordinatat: gjerësi gjeografike: Veri 40 gradë 52'24"; Jug 40 gradë 29'30" (qyteti 40 gradë 41'06");gjatësi gjeografike: Lindje 20 gradë 10'51"; Perëndim 19 gradë 44'30" (qyteti 19 gradë 56'40"). Rrethi mbulon një sipërfaqe prej 953,6 km katror (qyteti 1,6 km katror).

Rrethi i Beratit shtrihet kryesisht në një territory me reliev malor e kodrinor, me lartësi mesatare mbi nivelin e detit 455m (qyteti58m). Fushat shtrihen në krahun veri-perëndimor të rrethit, në luginën e Osumit, derisa ajo bashkohet me fushë ne Myzeqesë. Në mjedisin natyror të Beratit dallohen: zona fushore e kodrinore e Beratit dhe e Kuçovës ,mali i Tomorit (Lindje,2417m) dhe ai i Shpiragut(Perëndim,1218m) si edhe lugina e Osumit dhe e Tomoricës. Zona fushore dhe ajo kodrinore janë baza e zhvillimit të prodhimit bujqësor, ndërsa malet dhe luginat përfaqësojnë burime të mëdha pyjore, kullosore dhe hidrike,ende të pashfrytëzuara si potenciale të rëndësishme të zhvillimit ekonomik e mjedisor.

Berati u përket qyteteve të rrallë ku jeta fillon qysh në lashtësinë e thellë dhe vazhdon pa u ndërprerë derimë sot. Dy çekanë guri e datojnë fillimin e jetës në të para Periudhës së Bronzit (2600-1800 P. Kr.). Dëshmitë arkeologjike tregojnë se në shek.VII-VIP.Kr. Këtu është zhvilluar një vendbanim paraqytetar, me punishtet e tij të qeramikës dhe me një jetë shoqërore të diferencuar. Në kufijtë e legjendës dhe të historisë, ky vendbanim thuhet të ketë qenë Orestiada e lashtë,i quajtur kështu nga që aty banonin një fis i pellazgëve,orestët,i pari i të cilëve ishte Oresti, i biri i Agamemnonit. Qyteti i mirëfilltë u themelua më 313-310P.Kr.siqytet-kështjellë i Dasaretisë, i quajtur Antipatrea nga mbreti Kassandër në kujtim të gjeneralit mëkëmbës të Lekës së Madh. Ky është emri i pare i qytetit. Pas pushtimit romak në shek.IIP.Kr.ai u quajt prej tyre Albanorum Oppidum (FortesaeArbërve).Në shek.V, nën perandorinë Bizantine, u përforcua dhe e ndryshoi emrin në Βουλγερολις (qyteti bullgar, sllv. Belgrad) në shekullin eX[2].

Pas tronditjes që pësoi reputacioni i qytetit në vitin 1997, ka një rivendosje të imazhit të mirë, sidomos këto dy-tre vitet e fundit, kur janë shtuar ndjeshëm flukset e vizitorëve nga vendi, nga Kosova e të huaj. Vërehet një riaktivizim i traditive më të mira të qytetit kundrejt vizitorëve. Tradicionalisht në Berat vizitori ka gjetur mikpritje të veçantë, përjetimin e një ambienti të këndshëm e shlodhës, rastin që të shijojë një kuzhinë karakteristike tradicionale të kombinuar me atë moderne, ku përfshihen ullinjtë e famshëm, mishi i qengjit dhe ai i gjelit të detit dhe verërat e prodhuara nga vreshtat rreth qytetit.

Degë më e zhvilluar e turizmit deri më tani ka qenë punimet ë artizanatit. Artizanati,për qytetin është një vlerë e trashëguar e cila mirëmbahet edhe sot në Berat në disa gjini, si: gdhendje ne druqendistari, punim ene argjend dhe ne metalet e tjera,punime ne kashte, gdhendje ne pllaka guri, punime decorative me gur.
Vitet e fundit ka një rigjallërim të ketyre mjeshtërive.Vizitori mund të gjejë në disa dyqane gdhendje me pamje karakteristike të Beratit. Punimet e disa prej mjeshtrave të Beratit janë shpërndarë edhe jashtë vendit.[3] Në vitin 1901, Berati ishte qendër sanxhaku e varur nga vilajeti iJaninës.[4]

Turizmi është një ndër drejtimet më premtuese të zhvillimit ekonomik të Beratit.Qyteti trashëgon nga e kaluara një varg të gjatë e të pasur vlerash historike, kulturore, etnografike, arkitektonike e të besimeve, të tilla që përbëjnë një potencial të konsiderueshëm për turizmin. Me burimet turistike të qytetit është e mundur që të zhvillohet turizmi familiar dhe ai i organizuar. Në disa zona të rrethit (Tomor) mund të zhvillohet turizmi malor me shumë aspekte brenda tij, si edhe gjuetia.

Qyteti i Beratit

Vendodhja e Sheshit Teodor Muzaka

1.3- Plani i Përgjithshëm Vendor

PPV-ja e Beratit është përgatitur në 2016. Vizioni i propozuar për zhvillimit e Beratit synon të harmonizojë zhvillimin ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë.
Projekti P12 bazuar në përdorimin e tokës tek PPV bie në pronë publike
Duke iu referuar planit të qarkullimit, nënprojekti përfshin rrugën "Antipatrea" e cila është dhe rruga kryesore urbane, Gaqi Gjika, rrugë formëzuese bujqësore dhe rruga "Rilindja" që është një rrugë dytësore.
Duke qenë që ndërhyrja I referohet vetëm hapësiës publike nuk është identitfikuar asnjë udhëzim tjetër.





Fig: Plani i përdorimit të tokës (gri e lehtë – banim; lejla – institucione publike)





Fig: Rrjeti i transportit PPV (me të zezë të trashë– rrugë kryesore urbane; lejla – rrugë formëzuese dhe bujqësore; me të zezë të lehtë – rrugë dytësore.

Zona e mbrojtur UNESCO dhe kufijtë e trashëgimisë kulturore

Berati u shpall Qytet Muze në vitin 1961, si rezultat i përpjekjes së parë të Qeverisë Shqiptare për të ruajtur trashëgiminë arkitektonike dhe historike në qytete dhe fshatra dhe më pas i është nënshtruar rregullores kombëtare mbi trashëgiminë kulturore, së fundi e përmbledhur në Ligjin Nr. 27/2018 *"Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".* Zona e mbrojtur, e përbërë nga tre lagje: Gorica, Mangalemi dhe Kala, u përfshi nga UNESCO në Listën e Trashëgimisë Botërore (2008) si "Shembull i rrallë i një karakteri arkitektonik tipik të periudhës Otomane" duke përcaktuar qartë kufijtë e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur. Sipas kërkesave të UNESCO-s, që në vitin 2008 është përgatitur Plani i Menaxhimit dhe në vitin 2014 është përpiluar një dokument i ri në kuadër të projektit SUSTCULT.
Më tej, në vitin 2014, VKM nr. 767 ka përcaktuar një rregullore më të detajuar *"Për mbrojtjen, konservimin e integruar, administrimin e "Qendrës historike" dhe zonës së mbrojtur të qytetit të Beratit"*. Me rregullore, ndërhyrjet e mundshme në zonën e Qendrës Historike janë të kufizuara në restaurimin e ndërtesave ekzistuese, ndërkohë që në zonën e mbrojtur lejohen ndërtimet e reja me kufizime në lartësi, dendësi dhe stil arkitektonik
Nën-projekti ndodhet në zonën e mbrojtur UNESCO dhe korrespondon me "zona 3 – lindore fushore" e VKM Nr. 767, 12/11/2014.



Fig. 1: Qendra historike UNESCO (me të kuqe) dhe zona e mbrojtur (e verdhë)

Tab 1: Neni 6 VKM Nr. 767 – Ndërhyrjet e lejuara në zonën e mbrojtur në Berat

Nënzonat brenda zonës së mbrojtur do t'u nënshtrohen masave të ndryshme mbrojtëse specifike për secilën, duke u bazuar në karakteristikat e secilës. (...)

Zona III (lindore fushore)

Në këtë zonë përfshihet qendra urbane e qytetit. Për vetë terrenin fushor në të cilin shtrihet, kjo zonë paraqet një rëndësi të veçantë për mbrojtjen e qendrës historike. Ndërhyrjet e lejuara në këtë zonë janë:

1. Ruajtja e hapësirave të gjelbra ekzistuese, si dhe raportit ekzistues sipërfaqe e ndërtuar dhe zonë e gjelbër, e cila lejon fushëpamjen e qendrës historike nga qyteti.
2. Ndërtesat që kanë statusin "Monument" brenda kësaj zone iu nënshtrohen vetëm ndërhyrjeve konservuese restauruese.
3. Në këtë zonë mund të bëhen ndërtime të reja ose rikonstruksione të ndërtesave ekzistuese. Ndërtimet duhet t'u përmbahen disa specifikimeve për të mbrojtur pamjen dhe profilin e qytetit:

- Lartësia maksimale e lejuar për ndërtimet në këtë zonë është 5 kate, jo më tepër se 17 m deri në kornizën e çatisë.
- Nuk lejohen ndërtime me forma gjeometrike komplekse duke qenë se janë në kontrast me traditën ndërtimore lokale.
- Nuk lejohet ndërtimi i objekteve me karakter industrial.
- Nuk lejohen mbulimet e ndërtesave me çati me ngjyra të tjera ose me mbulesa të ndryshme nga forma tradicionale që janë lehtësisht të dallueshme brenda zonës.
- Ngjyrat e përdorura do të jenë në përputhje me ndërtimet tradicionale.

Zone IV (lindore kodrinore)

Kjo zonë ndodhet në lindje të qendrës historike dhe në veri të qendrës së qytetit. Pjesa kodrinore në këtë zonë që nga periudha osmane ka qenë me ndërtesa 2-3 kate me oborr. Ndërhyrjet e lejuara brenda kësaj zone janë:

1. Ndërtesat që kanë statusin "Monument" brenda kësaj zone i nënshtrohen vetëm ndërhyrjeve konservuese restauruese.
2. Lejohet të bëhen ndërtime të reja ose rikonstruksione të ndërtesave ekzistuese. Këto ndërtime do të kenë kufizime në lartësi, vëllim, formë, material dhe ngjyrë:

- Lartësia maksimale e lejuar për ndërtimet në këtë zonë është 3 kate, jo më tepër se 11 m deri në kornizën e çatisë.
- Në kompozimin arkitektonik të ndërtesave duhet të përdoren elementë morfologjikë të arkitekturës tradicionale.
- Nuk lejohen ndërtime me forma gjeometrike komplekse duke qenë se janë në kontrast me traditën ndërtimore lokale.
- Nuk lejohet ndërtimi i objekteve me karakter industrial.
- Ndërtesat e reja me destinacion banim të kenë lartësi 2-3 kate dhe duhet të mbulohen me çati 4-ujëse, sipas tipologjisë tradicionale.
- Nuk lejohen mbulimet e ndërtesave me çati me ngjyra të tjera ose me mbulesa të ndryshme nga forma tradicionale që janë lehtësisht të dallueshme brenda zonës.

- Ndërtesat e radhës së parë në rrugën nacionale, në të dy anët e saj, duke filluar nga Markata e deri në fund të kufirit të zonës së mbrojtur do të kenë karakteristikat e nënzonës III.
- Për ndërtimet në këtë zonë suvatimi i jashtëm është i detyrueshëm.
- Ngjyrat e përdorura do të jenë në përputhje me ndërtimet tradicionale.

Tab 2: Neni 7 VKM Nr. 767 – Ndërhyrjet e lejuara në zonën e mbrojtur të Beratit

Rrugët dhe sheshet

- Rrugët dhe sheshet e qendrës historike dhe zonës së mbrojtur ruhen në formulimin kompozicional si pjesë organike e këtyre zonave.

Në qendrën historike:

- Lejohen ndërhyrje për përmirësimin e infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, projekti i të cilave miratohet në KKR.
- Ndërhyrjet e rikonstruksionit në rrjetin rrugor dhe sheshe ruajnë detyrimisht materialet dhe teknikat tradicionale. Drurët dhe gjelbërimi tradicional në këtë zonë ruhen dhe pas degradimit ripërtërihen me të njëjtat lloje.

Në zonën e mbrojtur:

- Lejohet rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe shesheve, duke përdorur materiale tradicionale.



Fig: Kufijtë e rregullores për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e qendrës historike të Beratit dhe zonës së mbrojtur rrotull tij

1.4-VENDODHJA E SHESHIT

Sheshi i marre ne studim ndodhet ne qender te qytetit te Beratit, ne zonen me kryesore te tij. Shesh eshte i rrethuar nga objekte kulti, Xhamia dhe Kisha e qytetit gjithashtu dhe objekte shteterore, Bashkia e Qytetit. Ky shesh ka nje rendesi te vecante per qytetin e Beratit pasi ne te behen te gjitha aktivitetet Kulturore, festive etj. Sheshi ka nje aksueshmeri te mire nga te gjitha drejtimet pasi vete pozicioni i tij e mundeson kete aksesueshmeri ne te.



Qyteti i Beratit dhe pozicionimi i Sheshit.

1.5-QELLIMI I PERGJITHSHEM

Qellim I I pergjithshem I ketij projekti do te jete rehabilitimi i sheshit "Teodor Muzaka" si dhe zgjidhja e parkimit te automjeteve automobilistike per qytetin, permiresimin e peisazhit te qytetit dhe zgjidhjen e trafikut. Nderhyrja ne sheshin "Teodor Muzaka" do te krijoje nje atmosfere tjeter per qytetin, do te nxise bashkeveprimin midis komunitetit si dhe do te jete nje atraksion tjeter per turistet e ndryshem vendas e te huaj.

1.6-GJENDJA EKZISTUESE

Gjate studimit te gjendjes ekzistuese, u evidentuan problematikat kryesore qe kane nevoje te trajtohen ne kete projekt:

1-Sheshi ne veri kufizohet nga rruga "Santa Lucia" dhe sheshi "Iliaz Vrioni", ne jug me "Shetitoren Osumi", ne perendim nga ku mbyllet rruga historike" Antipatrea".

2-Sheshi ka pesuar degradime te ndryshme pergjate viteve , per shkak te cilesise se dobet te punimeve te meparshme, ku evidentohen prishja e shtresave te tij.

3-Sheshi gjate dites nuk eshte i frekuentuar, per shkak te nxehtesise qe ai emeton ne mjedis, mungeses se gjelberimit dhe mobilimit urban.

4-vihet re nje mungese e theksuar e vendeve te parkimit perreth sheshit duke veshtiresuar qarkullim/ndalimin e automjeteve.

Foto te gjendjes ekzistuese

1.7- KONCEPT IDEJA

Koncepti i sheshit eshte menduar si nje pjace e integruar me gjelberimin, ku ne te njejten kohe te jete nje shesh ku te kryen aktivitete te ndryshme por edhe te kete freskine e gjelberimit. Sheshi eshte menduar me dy funksione kryesore ate te nje pjace dhe parku si dhe parking nentokesore qe do jete ne sherbim te qytetit duke bere nje letesim per parkimin e automjeteve ne qytet. Gjelberimi eshte menduar te jete ne perimeter te sheshit dhe ne pjesen Jugore te tij ku shtrihet edhe lumi Osum, por me kete koncept bejme te mundur edhe integrimin e bulevardit te qytetit me shesh nje shkrirje armonike dhe natyrale ndermjet tyre. Koncepti dhe organizimi i zonave brenda sheshit eshte bere duke marre parasysh flukset e qytetareve duke krijuar aksesueshmeri ne shesh por edhe fushepamje si dhe gjelberim. Hyrjet per ne parkimin nentokesor jane menduar ne te dy anet e sheshit ku jane edhe flukset me te medhaja te automjeteve nga pjesa e qytetit rruga Antipatrea si dhe ne anen jugore nga rruga Santa Lucia qe eshte edhe rruge nacionale.

Koncept Ideja

1.8- PROJEKTI ARKITEKTONIK

Planimetria e Parkut

Pjesa e siperme e parkut eshte konceptuar si nje nderthurje e arkitektures te qytetit te Beratit edhe asaj moderne, duke bere integrimin e ketyre te dyjave sjellim nje projekt sa me armonik me qytetin por edhe modern ne te njejten kohe. Sheshi ka aksesueshmer nga te gjitha drejtimet e tije per qytetaret. Ne shesh jane dy hyrje per automjetet ne parkimin nentokesore hyrja Jeshile dhe hyrja e Kuqe, si dhe jane menduar edhe dy hyrje per kembesoret per ne parkim. Jane rruajtur parku i femijeve edhe Info Point-i por eshte menduar qe ti shtojme edhe nje objekt tjeter sheshit qe do te jete ne dispozicion te qytetareve por edhe turisteve te shumte qe vine ne qytet, Libraria eshte nje objekt ku nga forma do jete si objekti i pare por me arkitekture me kontemporane dhe armonike me sheshin e qytetin.

Planimetria e sheshit

Planimetria e Katit Nentoke

Parkingu nentokesore do kete nje kapacitet prej 198 vendesh parkimi, do kete dy hyrje per automjetet, hyrja jeshile qe ka aksesueshmeri nga rruga Santa Lucia si dhe hyrja e kuqe qe aksesohet nga rruga nacionale Antipatrea. Ne katin nentoke jane vendosur edhe ambjentet ndimese, si ambjentet teknike, nyjet higjenosanitare ku jane menduar 3 nhs per femra dhe 3 nhs per meshkuj si dhe nje nhs per persona me aftesi te kufuzuara. gjithashtu jane edhe dy ambjentet per personelin. Ne anen perendimore te sheshit jane menduar edhe dy shkallare ne forme spirale per qytetaret qe te nxjerrin ne pjesen e siperme te sheshit.



Planimetria e kati Nentoke

Prerje te Objektit

Lartesia e katit dysheme-tavan do jete 4.5m nje lartesi e mjaftueshme dhe komode per katin e nje parkingu. Ndersa lartesia dysheme-dysheme do jete 5.2m. Ne prerjet e paraqitura ne projekt jane evidentuar te gjitha detajet teknike te objektit, pjerresia e rampave eshte bere 15% qe te kete nje aksesueshmeri sa me te natyrale ne parkim si nga automjetet por edhe qytetaret qe do futen ne kembe.

PRERJA A-A



PRERJA 1-1



Libraria

Planimetria

Libraria eshte menduar si nje aset i shtuar ne shesh pasi do i jape nje tjeter atmosfere, volumi i librarise eshte menduar te jete si Zyra e infromacionit ekzistuese por do kete nje fasate arktektonike shume me armonike dhe kontemporane me sheshin dhe arkitekturen e qytetit duke perdorur materiale si dru,hekur dhe xham. Volumi i librarise edhe menduar ne nje kat ku jane te gjitha komponentet e nje librarie te vogel ku do promovohen te gjitha vlerat e qytetit po jo vetem, ajo do sherbeje edhe si nje pike referimi per qytetin.



Planimetria e katit

Fasadat e Objektit

FASADA JUGORE

FASADA LINDORE



FASADA VERIORE



FASADA PERENDIMORE



Detaje dhe Mobilim Urban




DETAJ STOLI 1


DETAJ STOLI 2






DETAJ STOLI 3


KOSH MBETURINASH I PA LEVIZESHEM
PAMJA BALLORE
PAMJA ANESORE
PREFUE
0,35
0,38
0,35
0,75
0,25
18
Ø40mm.
PLANIMETRIA
PREFUA PLANARE


Zgare Pemesh Tip - A
1.2
0.5
0.2
R0.25
1.2
0.2
1.1
0.2


Zgare Pemesh Tip - B
0.15
0.7
0.15
0.15
R0.35
1
1
0.3
0.25
0.8
0.25
0.45

KOSH MBETURINASH I LEVIZESHEM
KOSH
0,48
0,55
0,48
1,06


MBAJTESE BICIKLETASH
470
550
1950 -2550 - 3150

Ndriçim Shtylle Tip - A







Materiali (shtyllë): celik, me përbërës gize
Materiali (ndriçues): alumin i derdhur
Ngjyra: bronz ose gri e errët
Luminues: LED 3000/4000 K
Optika: asimetrike
Dimensionet: 7000-8000 mm
Mundësitë: mbajtëse të vetme dhe të dyfishtë për konfigurimin e një ose dy dritave

Distanca: 12-20m ndermjet ndricuesve, ne te dyia anet e rruges

Ndriçim Shtylle Tip - B





Materiali (shtyllë): celik, me përbërës gize
Materiali (ndriçues): alumin i derdhur
Ngjyra: bronz ose gri e errët
Luminues: LED 3000/4000 K
Optika: asimetrike
Dimensionet: 7000-8000 mm
Mundësitë: mbajtëse të vetme dhe të dyfishtë për konfigurimin e një ose dy dritave

Distanca: 12-20m ndermjet ndricuesve, ne te dyia anet e rruges

Ndriçim Shtylle Tip - C





Materiali (shtyllë): celik, me përbërës gize
Materiali (ndriçues): alumin i derdhur
Ngjyra: bronz ose gri e errët
Luminues: LED 3000/4000 K
Optika: asimetrike
Dimensionet: 4000-5000 mm (lartësia e vendosjes së llambës)

Distanca: 8-10m ndermjet ndricuesve, ne te dyia anet e rruges

RENDERA DHE PAMJE 3D



BASHKIA BERAT

NDERTIMI I GODINES SE PARKIMIT DHE HAPESIRAVE MBESHTEHTESE NE BERAT

Parkim Nëntokësor në Berat

Raporti i Llogaritjeve Strukturore



Tirane, 2020

Porositësi:	**Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
Objekti:	**Parkim Nëntokësor në Berat**
Titulli i Dokumentit:	**Raporti i Llogaritjeve Strukturore**
Faza e Projektit:	**Projekt Zbatimi**
Kodi i dokumentit:	**00286-P06-V1**

	KONSULENTI			**POROSITËSI**	
	Përgatiti:	Kontrolloi:	Miratoi:	Kontrolloi:	Miratoi:
Emri: Firma:	Taulant KARRIQI				
Statusi i Dokumentit:	**Përfundimtar**	**Kontrolluar**	**Miratuar**	**Kontrolluar**	**Miratuar**

Tiranë 2020

PËRMBAJTJA

Përmbajtja ..... **i**
Lista e Tabelave ..... **iii**
Lista e Figurave ..... **iv**
1 Hyrje **1**
2 Kriteret e projektimit **2**
2.1 Kodet, standardet dhe dokumentet teknike 2
2.1.1 Kodet 2
2.1.2 Standardet 2
2.2 Vetitë e materialeve dhe ngarkesat 3
2.2.1 Vetitë e materialeve 3
2.2.2 Ngarkesat 4
3 Konsiderimet për projektimin strukturor **5**
3.1 Veprimet 5
3.1.1 Pesha vetjake dhe veprimet e përhershme 5
3.1.2 Ngarkesat e përkohshme 6
3.1.3 Veprimi sizmik 6
3.2 Projektimi në gjendjen e fundit kufitare dhe faktorët e sigurisë 6
3.2.1 Gjendja Kufitare e Fundme ULS 7
3.2.2 Gjendja Kufitare e Shërbyeshmërisë SLS 9
3.2.3 Projektimi gjeoteknik 10
3.3 Materialet e përdorura për strukturat prej Betoni 11
3.3.1 Betoni 11
3.3.2 Çeliku i armimit 16
4 Analiza strukturore **18**
4.1 Modelimi 18
4.2 Metoda e analizës 19
4.3 Karakteristikat e ndërtesës rezistente ndaj tërmetit 20
4.3.1 Kombinimi i koeficienteve për veprimet e ndryshueshme 20
4.3.2 Klasa e rëndësisë dhe faktori i rëndësisë 20
4.3.3 Sistemi strukturor 20
4.4 Shtresa mbrojtëse e betonit 20
4.5 Ngarkesat 20
4.5.1 Ngarkesa e përhershme e elementëve strukturorë 21
4.5.2 Ngarkesa e përhershme e elementëve jo strukturorë 21
4.5.3 Ngarkesa e përkohshme 21
4.5.4 Presioni i dheut 21
4.5.5 Presioni i ujit nëntokësor 22
4.5.6 Ngarkesa nga temperatura 22
4.5.7 Kombinimet e ngarkesave 22
4.6 Rezultatet e analizës 23
4.6.1 Themeli i ndërtesës 23
Aneksi A: Përcaktimi i klasës minimale të betonit dhe shtresës mbrojtëse **24**

Aneksi B: Llogaritja e sasisë së armaturës për soletën 26

Aneksi C: Llogaritja e trarëve të parkimit 36
Aneksi D: Llogaritja e kolonave 46
Aneksi E: Llogaritja e pllakës së themelit 47
Aneksi F: Llogaritja e perdes me pilota 57
Referencat 72
Literatura 73

LISTA E TABELAVE

Tabela 2-1: Vetitë e materialeve 3
Tabela 2-2: Ngarkesat 4
Tabela 3-1: Dendësia nominale e materialeve të ndërtimit 6
Tabela 3-2: Koeficientet e kombinimit për veprimet mbi ndërtesa 7
Tabela 3-3: Koeficientet e kombinimit për veprimet mbi ndërtesa 8
Tabela 3-4: Koeficientet e kombinimit për veprimet mbi strukturat që mbajnë lëngje 8
Tabela 3-5: Vlerat llogaritëse të veprimit 8
Tabela 3-6: Vlerat projektuese të veprimeve për përdorim në situatat me ngarkesa aksidentale dhe sizmike 9
Tabela 3-7: Kombinimi i veprimeve për SLS 9
Tabela 3-8: Vlerat projektuese të veprimeve të përdorura në kombinimet e veprimeve 9
Tabela 3-9: Klasifikimi i pa depërtueshmërisë nga uji dhe kufizimi i plasaritjeve sipas EN 1992-3 10
Tabela 3-10: Faktorët e sigurisë për gjendjen kufitare të fundme për projektimin gjeoteknik 11
Tabela 3-11: Vlerat kufi të rekomanduara për përbërjen e betonit (EN 206-1) 14
Tabela 3-12: Klasat e uljes 15
Tabela 3-13: Vlerat e shtresës minimale mbrojtëse (Eurokodi 2 Tabela 4.4N) 15
Tabela 3-14: Diametri maksimal i shufrave për kontrollin e plasaritjeve 17
Tabela 4-1: Vlerat e ϕ për llogaritjen e ψ_{Ei} 20
Tabela 4-2: Rastet e ngarkesave 20
Tabela 4-3: Faktorët pjesorë për kombinimet e ngarkesave (ngarkesat e përhershme) 22
Tabela 4-4: Faktorët pjesorë për kombinimet e ngarkesave (ngarkesat e ndryshueshme) 22
Tabela 4-5: Kombinimet e Ngarkesave për ULS 22
Tabela 4-6: Kombinimet e Ngarkesave për SLS 23
Tabela 4-7: Kombinimet e ngarkesave për veprimin sizmik 23

LISTA E FIGURAVE

Figura 3-1: Klasat e ekspozimit mjedisor 12
Figura 3-2: Shtresa mbrojtëse nominale c_{nom} 13
Figura 3-3: Diagrama sforcim – deformacion për beton C30/37 në shtypje 16
Figura 3-4: Çeliku i armimit B500C – diagrama sforcim-deformacion e projektimit 16
Figura 4-1: Pamje 3D e modelit me elemente të fundëm 18
Figura 4-2: Pamje plane e soletës së parkimit 19

1 HYRJE

Në këtë raport paraqiten llogaritjet për parkimin nëntokësor në Berat, Bashkia Berat. Parkim është 1 kat nëntokë. Lartësia e lirë është 4.0 m. Konstruksioni është zgjedhur me sistem ramë betonarme, kolonë- tra dhe soletë monolite dhe me mur rrethues b/a.

Parkimi është projektuar në mënyrë të tillë që gjatë jetëgjatësisë së saj, me shkallën e duhur të besueshmërisë dhe në mënyrë sa më ekonomike të përballojë të gjitha veprimet dhe ndikimet që mund t'i ndodhin gjatë zbatimit dhe përdorimit si dhe të plotësojë kërkesat e caktuara të shërbimit të strukturës ose pjesëve të saj. Parkimi është projektuar për të pasur mjaftueshëm rezistencë strukturore, shërbyeshmëri dhe durueshmëri në situata të zakonshme dhe të jashtëzakonshme (p.sh. në rast tërmeti). Në rast zjarri, rezistenca strukturore është e përshtatshme për periudhën përkatëse kohore. Gjithashtu projektimi është kryer në mënyrë të tillë që dëmi nga ngjarje si shpërthime, goditje apo pasoja të gabimeve njerëzore, të jetë përpjesëtimor meshkakun fillestar.

Përveç kërkesave të përgjithshme që jepen në EN-1990 (bazat e projektimit strukturor); kërkesave të përbashkëta që jepen në EN 1991 (veprimet mbi struktura), EN 1997 (projektimi gjeoteknik) dhe EN 1998 (projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit); për kërkesat e veçanta për projektimin strukturor të parkimit nëntokësor është bazuar në eurokodin përkatës EN 1992, të lidhura me materialin kryesor ndërtimor, duke qenë se struktura mbajtëse e parkimit do të jetë prej betoni të armuar.

Si pjesë e kërkesave të mësipërme, për projektimin strukturor të parkimit nëntokësor, në mënyrë të posaçme veçohen:

- Pika 2.3 e EN 1990 – përdorimi i Kategorisë 4 të jetëgjatësisë projektuese, pra parkimi nëntokësor është projektuar duke siguruar një jetëgjatësi shërbimi jo më pak se 50 vjet;
- Aneksit A1 i EN 1990;
- Aneksit B i EN 1990 - për të arritur besueshmërinë e duhur, parkimi nëntokësor është projektuar duke mbajtur parasysh klasën e pasojave ("consequences class") CC2 si dhe Klasën e besueshmërisë ("reliability class") RC2;
- Pika 4.2.5 e EN 1998-1 – referuar projektimit sizmik, parkimi nëntokësor bënë pjesë në ndërtesa që i përkasin Klasës II të rëndësisë e për pasojë faktori i rëndësisë γ_I i dhënë është marr i barabartë me 1.0.

Në të gjitha rastet gjithashtu plotësohen kërkesat që rrjedhin nga KTP-të ekzistuese në fuqi.

2 KRITERET E PROJEKTIMIT

2.1 KODET, STANDARDET DHE DOKUMENTET TEKNIKE

Në këtë kapitull janë dhënë kodet, standardet dhe dokumentet teknike më të rëndësishme të cilat janë ndjekur dhe respektuar gjatë procesit të projektimit.

Projektimi i të gjithë zërave sipas fushave përkatëse përmbushin kërkesat e botimeve dhe rishikimeve më të fundit të kodeve dhe standardeve të organizmave teknike të mëposhtme:

- ISO International Organisation for Standardisation
- EN European Standards
- Të gjitha kodet, normat dhe standardet shqiptare përkatëse.

Për kodet, normat dhe standardet që nuk përmenden në mënyrë specifike, projektuesi ka përdorur dokumentet përkatëse më të rrepta nga organizmat e përmendura më sipër.

2.1.1 Kodet

- EN 1990 Eurokodi 0: Bazat e projektimit strukturor
- EN 1991 Eurokodi 1: Veprimet mbi struktura
- EN 1992 Eurokodi 2: Projektimi i strukturave prej betoni
- EN 1993 Eurokodi 3: Projektimi i strukturave prej çeliku
- EN 1997 Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik
- EN 1998 Eurokodi 8: Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit
- KTP 2-78 Kushtet teknike të projektimit për ndërtimet në zona sizmike (norma teknike për projektimin në zonat sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP N.2-98 Kushtet teknike projektimi për ndërtimet antisizmike (norma teknike për projektimin e strukturave anti-sizmike) - Kodet Shqiptare
- KTP 4-78 Kategorizimi dhe klasifikimi i veprave hidroteknike
- KTP 7-78 Përcaktimi i ngarkesës se erës
- KTP 8-78 Përcaktimi i ngarkesës se dëborës

Në Eurokodet strukturore, kërkesat e projektimit jepen në lidhje me kushtet specifike të gjendjeve kufitare. Llogaritjet për të përcaktuar aftësinë e pjesëve të ndryshme për të përmbushur një gjendje të veçantë kufitare janë bërë duke përdorur veprimet llogaritëse (ngarkesa dhe deformime) dhe rezistencat llogaritëse. Vlerat llogaritëse janë përcaktuar nga vlerat përkatëse të veprimeve dhe rezistencat karakteristike të materialeve nëpërmjet aplikimit të faktorëve të sigurisë.

2.1.2 Standardet

Betoni:	EN206-1:2000/A2:2005 - Concrete: Specification, performance, production and conformity EN 934:2008, 2009 - Admixtures for concrete, mortar and grout EN 1992: 2004 - Design of concrete structures EN 13670: 2009 - Execution of concrete structures

Çimento Portland:	EN 196:2005 - Methods of testing cement

	EN 197:2000 - Cement - Composition, specifications and conformity criteria for common cements
Çeliku i armimit: B500C	EN 10080: 2005 - Steel for the reinforcement of concrete EN ISO 15630 : 2005 - Steel for the reinforcement and prestressing of concrete – Test methods
Bulonat dhe Kunjat:	EN 26157 : 1991 - Fasteners - Bolts, screws and studs EN 28839:1991 - Mechanical properties of fasteners - Bolts, screws, studs and nuts EN ISO 4759-1:2000 - Tolerances for fasteners - Bolts, screws, studs and nuts

2.2 VETITË E MATERIALEVE DHE NGARKESAT

2.2.1 Vetitë e materialeve

Më poshtë paraqiten vetitë e materialeve kryesore që do të përdoren gjatë projektimit:

Tabela 2-1: Vetitë e materialeve

Përshkrimi	Vlera
BETONI (dhe aditiv për të reduktuar plasaritjet nga tkurrja për elementët e masiv)	
• Pesha:	
• Betoni masiv	γ_c = 24 kN/m^3 (*)
• Betoni i armuar	γ_c = 25 kN/m^3 (*) (*) EN 1991-1-1:2002 General actions - Densities, self-weight, imposed loads for buildings
• Rezistenca në shtypje në 28 ditë:	
• Betoni i varfër C12/15	f_{ck} = 12 N/mm^2
• Betoni strukturor C30/37	f_{ck} = 30 N/mm^2
ÇELIKU I ARMIMIT	
• Klasa:	Klasa – B500C
• Pesha njësi:	ρ = 7 850 kg/m^3
• Rezistenca në rrjedhshmëri:	f_y = 500 MPa
• Moduli i elasticiteti:	E_{sm} = 200 000 MPa
MBUSHJET	

Përshkrimi	Vlera
• Peshanjësidhekëndifërkimit(nëgjendjenatyrore):	
• Mbushjeme materialtë granuluar	γ=20 kN/m^3 φ = 35 °
• Mbushjeme materialshkëmbor	γ=21 kN/m^3 φ = 45 °
• Peshanjësi(nëgjendjepluskuese):	
• Mbushjeme materialtë granuluar	γ'=10 kN/m^3
• Mbushjeme materialshkëmbor	γ'=11 kN/m^3

2.2.2 Ngarkesat

Më poshtë paraqiten ngarkesat kryesore që do të përdoren gjatë projektimit:

Tabela 2-2: Ngarkesat

Përshkrimi	Vlera
Ngarkesa e përkohshme	
• Ngarkesaepërkohshmenëklasa,KategoriaC1	3.0 kN/m^2, 4.0 kN
• Ngarkesaepërkohshmenëtarracën+16.66, gjimnastika, KategoriaC4	5.0 kN/m^2, 5.0 kN
• Ngarkesaepërkohshmenëtarracat+8.50, gjimnastika, KategoriaC1	3.0 kN/m^2, 4.0 kN
• Shkallët	3.0 kN/m^2, 4.0 kN
• Muretmbushës	3.0 kN/m^2
• Shtresatedyshemesë	2.0 kN/m^2
Ngarkesa e erës dhe borës	
• Shpejtësiamaksimaleeerës(1:50vjet)	31 m/s
• Lartësiamaksimaleeborës(1:50vjet):	nuk është konsideruar (nën 500 m)
Të dhënat sizmike	
• PGAreferencë, RP1:475vjet	a_{gR} = 0.26 g (1)
• Tipi itruallit:	C
• Faktori irëndësisë(EN1998-1)	γ_I = 1.0 (1) Nga studimi sizmik

3 KONSIDERIMET PËR PROJEKTIMIN STRUKTUROR

3.1 VEPRIMET

Veprimet janë marrë nga pjesët e mëposhtme të Eurokodeve:

- EN 1991-1-1 Dendësia, pesha vetjake dhe ngarkesa e përkohshme
- EN 1991-1-2 Veprimet mbi strukturat e ekspozuara ndaj zjarrit
- EN1991-1-5 Veprimet termike
- EN 1991-1-6 Veprimet gjatë ndërtimit
- EN 1991-1-7 Veprime aksidentale për shkak të goditjeve dhe shpërthimeve
- EN 1991-3 Veprimet nga vinçat dhe makineritë
- EN 1991-4 Veprimet në sillosa dhe rezervuarë
- EN 1997 Projektimi gjeoteknik
- EN 1998 Eurokodi 8 (Pjesa 1 dhe 5) Projektimi i strukturave rezistente ndaj tërmetit

Një veprim i ndryshueshëm ka vlerat e mëposhtme përfaqësuese:

- Vlera karakteristike Q_k
- Vlera e kombinimit $\psi_0 Q_k$
- Vlera e shpeshte $\psi_1 Q_k$
- Vlera pothuajse e përhershme $\psi_2 Q_k$

Vlerat karakteristike dhe vlerat e kombinimeve përdoren për verifikimin e gjendjes së fundit kufitare dhe kontrollin në gjendjen e fundit të pakthyeshme të shërbyeshmërisë. Vlerat e shpeshta dhe pothuajse të përhershme përdorën për kontrollin e gjendjes së fundit kufitare duke përfshirë dhe veprimet aksidentale dhe gjendjen e fundit të kthyeshme të shërbyeshmërisë. Vlerat pothuajse të përhershme përdorën gjithashtu për llogaritjen e veprimeve me kohë të gjatë.

Vlerat projektuese të veprimeve (ngarkesave) jepen nga:

$$\text{Veprimi (ngarkesa) llogaritëse} = \gamma_F \times \psi F_k$$

ku F_k është vlera karakteristike e specifikuar, γ_F është vlera e faktorit të sigurisë për veprimin (γ_A për veprimet aksidentale, γ_G për veprimet e përhershme, γ_Q për veprimet e ndryshueshme) dhe gjendjen kufitare të marrë në konsideratë, dhe ψ është 1.0, ψ_0, ψ_1 ose ψ_2. Vlerat e rekomanduar të γ_F dhe ψ jepen në EN 1990 Bazat e projektimit strukturor.

3.1.1 Pesha vetjake dhe veprimet e përhershme

Pesha vetjake e strukturës dhe komponentëve të saj llogaritet në përputhje me EN 1991 në bazë të përmasave nominale dhe vlerave karakteristike të dendësive të dhëna në EN 1991 – 1, Aneksi A – Tabelat për dendësinë nominale të materialeve të ndërtimit, dhe dendësia nominale dhe këndet e vendosjes për materialet e ruajtura. Më poshtë jepen vlerat nominale të dendësisë së materialeve të përdorura:

Tabela 3-1: Dendësia nominale e materialeve të ndërtimit

Materiali	Dendësia Nominale (kN/m^3)
Betoni (pesha normale, i paarmuar)	24.0
Betoni (pesha normale, i armuar)	25.0
Llaç – çimento	23.0
Tulla	19
Çelik	78.5

Gjithashtu janë përfshirë dhe veprimet e përhershme si të shtresave të soletave: 2.5 kN/m^3.

3.1.2 Ngarkesat e përkohshme

Ngarkesat e përkohshme janë ato siç janë specifikuar në kapitullin 2.2.2 Ngarkesat faqe 4.

3.1.3 Veprimi sizmik

Për projektimin e strukturës së ndërtesës, do të përdoret spektri i reagimit që jepet në Eurokodin 8 (EN 1998-1). Sipas EN 1998-1 klasa e rëndësisë për strukturën e ndërtesës të këtij projekti klasifikohet në: Klasa e rëndësisë II: Ndërtesë të zakonshme, që nuk u përkasin kategorive të tjera: $\gamma_I = 1.0$.

- Nxitimi maksimal i truallit për truall të tipit A është: a_{gR}=0.266g (1/475 vjet)("Studimit Sizmik");
- Vlera projektuese e veprimit sizmik është: $a_g = \gamma_I \times a_{gR}$=1.0x0.266g=0.266g(1/475 vjet);
- Klasa e truallit:C;
- Për tipi 1 të spektrit elastik të reagimit: S=1.15, T_B(s)=0.2, T_C(2)=0.6, T_D(s)=2;
- Faktori i sjelljes së strukturës: q=3.90 (shih **Error! Reference source not found.**).

3.2 PROJEKTIMI NË GJENDJEN E FUNDIT KUFITARE DHE FAKTORËT E SIGURISË

Në kodet strukturore Evropiane, përdoret koncepti i projektimit sipas gjendjes kufitare. Janë marrë në konsideratë: Gjendja Kufitare e Fundme (ULS – Ultimate Limit State) dhe Gjendja Kufitare e Shërbyeshmërisë (SLS – Serviceability Limit State), si edhe Durueshmëria. Faktorët e sigurisë janë përfshirë si në ngarkesat llogaritëse ashtu dhe në rezistencat e materialeve, për të siguruar shmangien e shkatërrimit (p.sh., mos përmbushja e një prej kërkesave të projektimit). Elementet janë llogaritur si fillim për të përmbushur gjendjen kufitare më kritike dhe me pas janë kontrolluar për të siguruar që të mos arrihen gjendjet e tjera kufitare.

Për shumicën e elementëve strukturor, gjendja kritike e marrë në konsideratë është ULS-ja, në të cilën është bazuar rezistenca e kërkuar e elementëve në përkulje, prerje dhe përdredhje. Kërkesat e gjendjeve të ndryshme SLS, siç mund të jetë deformimi apo plasaritjet, janë konsideruar pas këtij procesi.

Duke qenë se raporti i përshtatshëm i hapësirës me lartësinë efektive të elementeve h/d (për të mënjanuar deformimet e tepërta) dhe zgjedhja e një hapi të përshtatshëm midis shufrave (për të mënjanuar plasaritjet e tepërta), ndikohen nga niveli i sforcimeve në armaturë, projektimi sipas gjendjes kufitare është një proces interaktiv. Megjithatë, është normale që të niset me kërkesat e gjendjes ULS.

3.2.1 Gjendja Kufitare e Fundme ULS

Veprimet projektuese që janë marrë në konsideratë për projektimin strukturor tregohen në tabelën e mëposhtme. Është përdorur ekuacioni Ek. 6.10 ose ekuacionet më pak të favorshme Ek. 6.10a dhe Ek. 6.10b. Për opsionin 2b, vlera e koeficientit të sigurisë kur ngarkesa është e pafavorshme për veprimet e përhershme jepet nga $\xi\gamma_G = 0.85 \times 1.35 = 1.15$. Për të gjitha veprimet e përhershme nga i njëjti burim, për shembull, pesha vetjake e strukturës, është përdorur në të gjitha pjesët qoftë vlera e favorshme dhe e pafavorshme. Kur veprimet e ndryshueshme janë të favorshme, është përdorur vlera Q_k = 0. Aty ku është e nevojshme, secila ngarkesë e ndryshueshme me radhë është konsideruar si ngarkesë kryesore. Nëse $Q_{k,1}$ lidhet me një zonë magazinimi, për të cilën ψ_0 = 1.0, Ek. 6.10 dhe Ek. 6.10a janë identike. Në raste të tjera, është përdorur Ek. 6.10a/b, ku Ek. 6.10b aplikohet përvlerat e $G_k \leq 4.5Q_k$ kur $\psi_0 = 0.7$, dhe përvlerat e $G_k \leq 7.5Q_k$ kur $\psi_0 = 0.5$.
Është kontrolluar Gjendja kufitare e fundme si mëposhtë:

a. EQU: Humbja e ekuilibristatik të strukturës ose të ndonjë pjese të saj të konsideruar si njëtrupi ngurtë.
b. STR: Humbja e qëndrueshmërisë ose deformime të tepërta të strukturës ose elementeve të saj, duke përfshirë plintat, pilotat, muret e bodrumit, etj.
c. GEO: Humbja e qëndrueshmërisë ose deformime të mëdha të truallit ku rezistenca e dheut ose shkëmbit nuk janë të mjaftueshme për të siguruar qëndrueshmërinë.

Për gjendje kufitare të ekuilibrit statik të strukturës (EQU), kontrollohet që:

$$E_{d,dst} \leq E_{d,stb}$$

ku:

$E_{d,dst}$: është vlera projektuese e veprimeve destabilizuese;

$E_{d,stb}$: është vlera projektuese e veprimeve stabilizuese.

Për gjendjen kufitare të thyerjes ose deformimeve të tepërta të një seksioni, elementi apo lidhje (STR dhe/ose GEO), kontrollohet që:

$$E_d \leq R_d$$

ku:

E_d: është vlera projektuese e një faktori si p.sh. forcë e brendshme, moment ose vektor që përfaqëson disa forca të brendshme ose momente;

R_d: është vlera projektuese e rezistencës përkatëse.

Kombinimet e veprimeve projektuese që janë marrë në konsideratë dhe vlerat e faktorit ψ që janë përdorur tregohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3-2: Koeficientet e kombinimit për veprimet mbi ndërtesa

Gjendja e Kufitare e Fundme (ULS)	Kombinimi i Veprimeve (shih EN 1990)
Veprime të vazhdueshme dhe kalimtare (Ek. 6.10)	$\Sigma\gamma_{G,j}\,G_{k,j}$ "+" $\gamma_{Q,1}\,Q_{k,1}$ "+" $\Sigma\gamma_{Q,i}\,\psi_{0,i}\,Q_{k,i}$ (j ≥ 1, i > 1)
Veprime të vazhdueshme dhe kalimtare, përveç gjendjes kufitare STR dhe GEO, më pak e favorshmja midis (Ek. 6.10a or 6.10b)	$\Sigma\gamma_{G,j}\,G_{k,j}$ "+" $\gamma_{Q,1}\,\psi_{0,1}\,Q_{k,1}$ "+" $\Sigma\gamma_{Q,i}\,\psi_{0,i}\,Q_{k,i}$ (6.10a) $\Sigma\xi_j\gamma_{G,j}G_{k,j}$ "+" $\gamma_{Q,1}Q_{k,1}$ "+" $\Sigma\gamma_{Q,i}\psi_{0,i}Q_{k,i}$ (6.10b) (j ≥ 1, i > 1)
Kombinimi për Gjendjen e Fundme (Veprim aksidental)	A_d "+" $\Sigma G_{k,j}$ "+" $(\psi_{1,1}$ or $\psi_{2,1})\,Q_{k,1}$ "+" $\Sigma\psi_{2,i}Q_{k,i}$ (j≥1, i>1)
Kombinimi për Gjendjen e Fundme (Veprim sizmik)	$\Sigma G_{k,j}$ "+" A_{Ed} "+" $\Sigma\psi_{2,i}\,Q_{k,i}$ (j ≥ 1, i ≥ 1)
Shënim: "+" nënkupton "të kombinohet me", Σ nënkupton "efektii kombinuari", ξ është koeficientii zvogëlimit për ngarkesat e përhershme jo të favorshme G.	

Vlerat e faktorëve γ dhe ψ për veprimet janë marrë nga EN 1991 dhe nga EN 1990 Ankesi A.

Tabela 3-3: Koeficientet e kombinimit për veprimet mbi ndërtesa

Ngarkesat e përhershme (Kategoria dhe tipi, EN 1991-1-1)	ψ_0	ψ_1	ψ_2
A: Zonë e banuar, rezidenciale, B: Zonë me zyra	0.7	0.5	0.3
B : zonë me zyra	0.7	0.5	0.3
C: zonë me grumbullim njerëzish, D: zonë pazari	0.7	0.7	0.6
E: zonë magazinimi	1.0	0.9	0.8
F: zonë me trafik (pesha e makinave ≤ 30 kN)	0.7	0.7	0.6
G: zonë trafiku (30 kN < pesha e makinave ≤ 160 kN)	0.7	0.5	0.3
H: taraca	0.7	0	0
Temperatura (jo nga zjarri) në ndërtesa (shiko EN 1991-1-5)	0.6	0.5	0

Në kombinimet e veprimeve të projektimit të treguara më sipër, $Q_{k,1}$ është ngarkesa kryesore e ndryshueshme dhe $Q_{k,i}$ janë veprimet e ndryshueshme shoqëruese. Aty ku është e nevojshme, me radhë, secili veprim është konsideruar si ngarkesë kryesore e ndryshueshme.

Tabela 3-4: Koeficientet e kombinimit për veprimet mbi strukturat që mbajnë lëngje

Veprimi	ψ_0	ψ_1	ψ_2
Ngarkesat e lëngjeve	1.0	0.9	0.3
Uljet e themelit	1.0	1.0	1.0
Ngarkesatepërkohshmeosedeformimet	0.7	0.5	0.3
Veprime termike	0.6	0.5	0

Tabela 3-5: Vlerat llogaritëse të veprimit

Kombinimi	**EN 1990**	**Veprime të përhershme**		**Veprimi i ndryshueshme kryesor**	**Veprime të ndryshueshme**	
		Të pafavorshme	**Të favorshme**		**Kryesori (nëse ka)**	**Të tjerë**
		$\gamma_{Gj,sup}G_{kj,sup}$	$\gamma_{Gj,inf}G_{kj,inf}$	$\gamma_{Q,1}Q_{k,1}$	$\gamma_{Q,1}\psi_{0,1}Q_{k,1}$	$\gamma_{Q,i}\psi_{0,i}Q_{k,i}$
EQU (Seti A)	Ekuacioni 6.10	1.10 1.35	0.90 1.15	1.50 (0 ku është i favorshëm)	-	1.50 (0 ku është i favorshëm)
STR/GEO (Seti B)	Ekuacioni 6.10	1.35	1.00	1.50 (0 ku është i favorshëm)	-	1.50 (0 ku është i favorshëm)
STR/GEO (Seti B)	Ekuacioni 6.10a	1.35	1.00	-	1.50 (0 ku është i favorshëm)	1.50 (0 ku është i favorshëm)
STR/GEO (Seti B)	Ekuacioni 6.10b	$\gamma_{Gj,sup}$=1.35 ξ = 0.85	1.00	1.50 (0 ku është i favorshëm)	-	1.50 (0 ku është i favorshëm)
STR/GEO (Seti C)	Ekuacioni 6.10b	1.00	1.00	1.30 (0 ku është i favorshëm)	-	1.30 (0 ku është i favorshëm)

Koeficientet e kombinimit e veprimeve për gjendjen kufitare të fundme në projektimin për situatat me ngarkesat aksidentale dhe sizmike (shprehja 6.11a deri tek 6.12b në EN 1990) janë 1,0. Vlerat e faktorit ψ jepen në EN 1990, Tabela A1.1.

Tabela 3-6: Vlerat projektuese të veprimeve për përdorim në situatat me ngarkesa aksidentale dhe sizmike

Kombinimi	EN 1990	Veprimi i përhershëm		Ngarkesa kryesore aksidentale ose sizmike	Veprimi i ndryshueshëm	
		I pafavorshëm	I favorshëm		Kryesor (nëse ka)	Të tjerë
Aksidental	6.11a/b	$G_{kj,sup}$	$G_{kj,inf}$	A_d	$\psi_{1,1}$ or $\psi_{1,1}Q_{k,1}$	$\psi_{2,i}Q_{k,i}$
Sizmik	6.12a/b	$G_{kj,sup}$	$G_{kj,inf}$	$\gamma_I A_{Ek}$ or A_{Ed}	$\psi_{2,i}Q_{k,i}$	
Shënim: Në rastet e situatave të kombinimit aksidental, veprimi kryesor i ndryshueshëm mund të merret me vlerën e tij më të shpeshtë, si në rastin e kombinimit sizmik me vlerën e tij pothuaj të përhershme						

Faktori i sigurisë për vetitë e materialeve dhe produkteve janë marrë nga EN 1992.

3.2.2 Gjendja Kufitare e Shërbyeshmërisë SLS

Është kontrolluar që:

$$E_d \leq C_d$$

Ku:

C_d: është vlera kufitare e projektimit për kriterin përkatës të shërbyeshmërisë;

E_d: është vlera projektuese e veprimeve të specifikuara në kriterin e shërbyeshmerisë, e përcaktuar në bazë të kombinimit përkatës.

Tabela 3-7: Kombinimi i veprimeve për SLS

Gjendja kufitare e shërbyeshmërisë (SLS)	Kombinimi i veprimeve (shih EN 1990)
Kombinimi karakteristik (funksioni, përfshirë dëmtimet e elementeve strukturore dhe jostrukturore, p.sh. muret ndarëse)	$\Sigma G_{k,j} + Q_{k,1} + \Sigma \psi_{0,i} Q_{k,i}$ $(j \geq 1, i > 1)$
Kombinimi i shpeshtë (përdorimi i makinerive, shmangia e pellgjeve të ujit, etj.)	$\Sigma G_{k,j} + \psi_{1,1} Q_{k,1} + \Sigma \psi_{2,i} Q_{k,i}$ $(j \geq 1, i > 1)$
Kombinimi pothuajse i përhershëm (pamja)	$\Sigma G_{k,j} + \Sigma \psi_{2,i} Q_{k,i}$ $(j \geq 1, i \geq 1)$
Shënim: "+" nënkupton "të kombinohet me", Σ nënkupton "efekti i kombinuari", ξ është koeficienti i zvogëlimit për ngarkesat e përhershme jo të favorshme G.	

Për gjendjen kufitare të shërbyeshmërisë faktori i pjesshëm është marrë 1,0 përveç rastit kur specifikohet ndryshe nga EN 1991 deri në EN 1999.

Tabela 3-8: Vlerat projektuese të veprimeve të përdorura në kombinimet e veprimeve

Kombinimi	Veprimi i përhershëm		Veprimi i ndryshueshme	
	I pafavorshëm	I favorshëm	Kryesori	Të tjerë
Karakteristik	$G_{kj,sup}$	$G_{kj,inf}$	$Q_{k,1}$	$\psi_{0,i}Q_{k,i}$
I shpeshtë	$G_{kj,sup}$	$G_{kj,inf}$	$\psi_{1,1}Q_{k,i}$	$\psi_{2,i}Q_{k,i}$

Pothuajse i përhershëm	$G_{kj,sup}$	$G_{kj,inf}$	$\psi_{2,1}Q_{k,i}$	$\psi_{2,i}Q_{k,i}$

Për gjendjen kufitare të shërbyeshmërisë, plasaritjet në strukturat mbajtëse të lëngjeve, klasifikimi i strukturave për që mbajnë lëngje në lidhje me shkallën e kërkuar për mbrojtje nga rrjedhja dhe kërkesat përkatësetëprojektimitsiçjepennëEurokodin2:Pjesa3,strukturateveprëssëmarrjesklasifikohensi:

Tabela 3-9: Klasifikimi i pa depërtueshmërisë nga uji dhe kufizimi i plasaritjeve sipas EN 1992-3

Klasi	Kërkesat për rrjedhje	Dispozitat projektuese
1	Rrjedhja kufizohet në sasitëvogla.Disanjolla sipërfaqësore të pranueshme.	Hapjaeplasaritjeveqëpritettëkalojnëpërmestrashësisësë seksionit duhettëkufizohennëw_{k1}qëpërcaktohetnga$0.05 \le w_{k1} = 0.225(1 - h_w/45h) \le 0.2$ mm, ku h_w/h është gradienti hidraulik (p.sh., humbja e fluidit i ndarë nga trashësia e seksionit) nëthellësinëemarrënë konsideratë.Atykutrashësiaeplotëe seksionitnukështëplasaritur, aplikohet dispozita e dhënë në EN 1992-1-1

Nënkuptohet, por nuk është plotësisht e përcaktuar në Eurokodin 2: Pjesa 3, që kontrolli i plasaritjeve mund të kryhet nën ngarkim pothuajse të përhershëm. Në këtë rast, derisa $\psi_2 = 0.3$ për ngarkim hidrostatik, kontrolli i plasaritjeve mund të rezultojë me kushte me pak të rënduara se kërkesa kufitare e projektimit. Gjithashtu duket se efektet termike nuk ndikojnë në kontrollin e plasaritjeve, derisa në këtë rast $\psi_2 = 0$. Derisa efektet termike zakonisht mund të anashkalohen në gjendje kufitare të fundme, duke u bazuar në faktin që sforcimet "elastike" zvogëlohenmerritjenedeformimeve,duketsikurefektiiveprimevetermike mund të mos merret fare parasysh në projektim.

3.2.3 Projektimi gjeoteknik

Eurokodi 7: Projektimi gjeoteknik jep një përmbledhje të kërkesave për projektimin e strukturave gjeoteknike. Ai i klasifikon strukturat në tre kategori sipas kompleksitetit të tyre dhe rrezikut që lidhet me to, por përqendrohet dhe në projektimin e strukturave konvencionale pa rreziqe të jashtëzakonshme. Këto përfshijnë themelet e veçantë, të tipit pllakë dhe me pilota, struktura mbajtëse, pila të urave, argjinatura dhe tunele. janë marrë në konsideratë gjendjet kufitare të qëndrueshmërisë, rezistencës dhe shërbyeshmërisë. Kërkesat e gjendjeskufitaretëfundmedheasajtëshërbyeshmërisëmundtëarrihennëpërmjetdisametodave,veçmasose në kombinim.

Metoda e llogaritjeve e adoptuar në këtë projekt për gjendjen kufitare të fundme është Qasja e Projektimit 1 (Design Approach 1): e cila kërkon marrjen në konsideratë të dy kombinimeve të faktorëve të sigurisë për veprimet dhe parametrat e dherave, siç tregohet në tabelën vijuese. Në përgjithësi, kombinimi 2 përcakton përmasën e përgjithshme të strukturës dhe kombinimi 1 përcakton projektimin strukturor të elementëve të ndryshëm. Parametrat karakteristike të dherave përcaktohen nga vlerësime të kujdesshme të vlerave që ndikojnë në ndodhjen e një gjendjeje kufitare. Si rrjedhim, për kombinimin 2, vlerat llogaritëse për rezistencën e dheut në gjendjen e fundit kufitare jepen nga:

$$\tan \phi'_d = (\tan \phi')/1.25 \text{ and } c'_d = c'/1.25$$

Tabela 3-10: Faktorët e sigurisë për gjendjen kufitare të fundme për projektimin gjeoteknik

Kombinimi	Faktori i sigurisë për Veprimet[a], γ_F		Faktori i sigurisë për parametrat e dherave, γ_M		
	γ_G $\gamma_{G,fav}$	γ_Q -	$\gamma_{\phi'}$	$\gamma_{c'}$	γ_{cu}
1	1.35 1.00	1.50 0.00 (fav.)	1.00	1.0	1.0
2	1.00 1.00	1.30 0.00 (fav.)	1.25	1.25	1.4

Ku: c' dhe ϕ' janë përkatësisht vlerat karakteristike të kohezionit dhe këndit të fërkimit të brendshëm (në terma të sforcimeve efektive).

Vlerat llogaritëse për rezistencën në prerje në sipërfaqen e kontaktit të bazamentit me dheun, përkatësisht për rastin me drenim (fërkim në bazë) dhe pa drenim (adezion në bazë), jepen nga:

$$\tan\delta_d = \tan\phi'_d \text{ (për beton të derdhur në vend) dhe } c_{ud} = c_u/1.4 \text{ Ku } c_u$$

është rezistenca në prerje pa drenim.

Për bazamentet në dhera argjilor, rezistenca mbajtëse dhe në rrëshqitje është kontrolluar për kushtet me veprim të gjate kohor (me drenim) dhe veprim të shkurtër (pa drenim). Praktika e zakonshme në të cilën merren në konsideratë veprimet karakteristike dhe presionet mbajtëse të lejuara, për të kufizuar deformimin e truallit dhe rezistencën mbajtëse, mund të pranohet me mirëkuptim reciprok. Në këtë rast, është pranuar një variacion linear i presionit mbajtës të truallit për ngarkesa jashtëqendrore.

3.3 MATERIALET E PËRDORURA PËR STRUKTURAT PREJ BETONI

3.3.1 Betoni

Të dhënat kryesore për "beton efektiv", siç specifikohen me poshtë janë:

- klasifikimi i ekspozimit dhe shtresa mbrojtëse;
- klasa e rezistencës;
- klasa e konsistencës;
- uji i përzierjes;
- tipi i çimentos;
- tipi dhe përmasa maksimale e agregateve;
- aditivët.

3.3.1.1 Kërkesat

Ndërtesa është projektuar dhe do të zbatohet në një mënyrë të atillë që me një shkallë të përshtatshme sigurie dhe vlere ekonomike, gjatë kohës së shfrytëzimit, do të:

- përballojë të gjitha ngarkesat dhe veprimet që mund të ndodhin gjatë zbatimit dhe shfrytëzimit, dhe

- tëmbetetepërshtatshmepërpërdoriminqëikërkohet.

Siguria e kërkuar për strukturat në EN 1990 do të arrihet:

- nëpërmjet projektimit sipas normave nga EN 1990 deri në EN 1999 dhe
- nëpërmjet zbatimit të përshtatshëm dhe masave të kontrollit të cilësisë.

3.3.1.2 Jetëgjatësia

Jetëgjatësia specifikohet duke u bazuar në EN 1990. Përkufizimi i jetëgjatësisë është: "periudha e supozuar gjatëtëcilëssstrukturaosenjëpjesëesajduhetpërdorurpërqëlliminecaktuarmemirëmbajtje të paracaktuar por pa pasur nevojë për riparime të mëdha".

Sistemi i dedektimit te zjarrit eshte i paisur me nje bateri per autonomi per 24 ore per nje funksionim te plote per te gjithe sistemin (24 ore sistem i dedektimit te zjarrit dhe 1 ore alarm).
Sistemi qendror duhet te jete, ne menyre opzionale, i zgjerueshem per te gjithe ndertesen.
Detektoret do te lidhen me kabllo sipas fabrikatit te cilat do te instalohen vecmas nga te gjitha instalimet e tjera ne tuba ose kanalina.
Kabllot per paisjet e alarmit duhet te jene rezistente ndaj zjarrit per 90 minuta, komponentet e suportit te kabllove (morsetat) duhet te jene rezistente ndaj zjarrit per te njejten kohe. Nuk lejohet qe te instalohen sisteme suporte kabllosh, komponente, paisje kabllosh e me radhe, te cilat kane nje rezistence me te vogel ndaj zjarrit se vete kabllot.
Nese kabllot rezistente ndaj zjarrtit do te instalohen vertikalisht ne mur, kablloja duhet te shtrihet cdo 3m ne forme laku (mase mbrojtese ndaj rreshqitjes se kabllos).

Pershkrimi i produkteve

Detektori optik i tymit i adresueshme

Ne saje te aftesise se tij te larte te perpunimit, eshte ne gjendje te analizoje ne menyre eficiente gjendjen e zones se mbrojtur, duke garantuar imunitet te larte ndaj alarmeve terreme.

- *Tensioni i furnizimit: 17V to 30V DC*
- *Rryma nominale: 450 uA max.*
- *Rryma ne gjendje alarmi: 4mA*
- *Ndjeshmeria: Ne perputhje me standartin EN54-5 dhe EN54-7*
- *Madhesia e kabllit per morseten:0.5-2.5mm^2*
- *Koha e risetimt: 20sek. max*
- *Temperatura e operimit: -10 - 50°C*

Detektori i temperatures i adresueshme

Ky detektor kontrollon temperaturen e ambientit, me te cilin eshte pajisur. Ne saje te algoritmit te analizimit te implementuar ne brendesi te tij, garanton pergjigje eficiente dhe imunitet te larte ndaj alarmeve te rreme. Nepermjet programatorit, mund te pershtatet si detektor termik, me prag te fiksuar ose ne temperature te larte.

- *Tensioni i furnizimit: 17V to 30V DC*
- *Rryma nominale: 450 uA max.*
- *Rryma ne gjendje alarmi: 4mA*
- *Ndjeshmeria: Ne perputhje me standartin EN54-5 dhe EN54-7*

- *Madhesia e kabllit per morseten:0.5-2.5mm^2*
- *Kufiri e veprimit: 55/65/75/85°C*
- *Koha e risetimt: 20sek. max*
- *Temperatura e operimit: -10 - 50°C/-10 - 85°C*
- *I paisur me llampushke sinjalizuese*

Sinjalizuesi optik/akustik

I adresueshem per konsum te ulet, i pershtatur per te gjithe centralet analoge te adresueshemte detektimit te zjarrit, me ushqim direkt nga loop. Duhet te instalohet ne cdo hapsire te brendshme ku ka edhe pulsant manual, gjithashtu edhe jashta referuar projektit. Fuqia e emetimit te tingullit, e rregullueshme, deri ne 100dB

- *Tensioni i ushqimit: Nga qarku 20 V deri ne 30 V DC*
- *Rryma nominale ne alarm: 0.5mA*
- *Temperatura e operimit: -10ºC to 50ºC*
- *Shkalle mbrojtje: IP44, tipi A*

Pulsanti i alarmit

Pulsanti i alarmit lidhet ne menyre direkte me loop e detektimit te centraleve analogete adresueshem. Duke shtypur ne pjesen e aktivizimit (qe tregohet qarte sipas pershkrimevete Normes EN54-11), mekanizmi i thjeshte, por i mprehte riprodhon efektin e caktuar ngathyerja e nje xhami, pulsanti mund te perpunohet thjeshtesisht duke duke perdorur çelesin plastik ne aparature.

Ky tip pulsanti eshte ideal per te gjitha ato aplikacione subjekte te aktivacioneve te rremefrekuente (shkolla, qendra tregtare dhe vende te tjera publike).

Ngjyra e kuqe

- *Tensioni i ushqimit: Nga qarku 20 V deri ne 30 V DC*
- *Rryma nominale ne alarm: 3.1mA*
- *Temperatura e operimit: -10ºC to 50ºC*
- *Shkalle mbrojtje: IP24D*
- *i paisur me celes per rikthimin ne gjendje normale*

Indikatori ne distance

Perserites optik me LED qe tegon ne distace qe sensori brenda tavanit eshte ne alarm. Ky sensor komunikon vetem me sensorin brenda tavanit.

- *Tensioni i ushqimit: Nga qarku 3.3 V deri ne 10 V DC*
- *Rryma nominale ne alarm: 7mA*
- *Temperatura e operimit: -10ºC to 50ºC*

Paneli distant i kontrollit dhe vizualizimit me ekran LCD

Eshte nje tastiere opsionale e pajisur me LED, taste dhe ekran qe replikon te gjitha funksionete panelit frontal te centralit. Lokalizohet ne pikat ku eshte i nevojshem ofrimi i mundesise sekontrollit dhe

vizualizimit. Çdo central SmartLoop administron deri ne 8 perserites, te cilet mund te lidhen ne nje distance maksimale prej 1000 m nga centrali. Lidhja me centralin realizohet nepermjet busit RS485, gjithmone te pranishem ne skeden kryesore te centraleve.
Central me 2 loop, te zgjerueshem me 8, i pajisur me panelin e komandimit me ekran LCD.

- *Nr i qarqeve: 2 loops - Max 275 mA per loop*
- *Dalje sirene: 2 me 28 V DC / 500 mA secila*
- *Dalje rele ne rast zjarri : 2 me 50 VAC / DC 1A*
- *Dalje rele ne alarm: 1 me50 VAC / DC 1A*
- *Konsumi vetjak: 65W, 130mA per qark.*
- *Temperatura e operimit: -10ºC to 50ºC*
- *Shkalla e mbrojtjes: IP21*
- *I paisur me bateri emergjense 12V 7Ah*
- *Kapaciteti i qarkut: 125 paisje max.*
- *Gjuhet: i paisur me disa gjuhe*
- *Programimi: mundesi programimi ne tastiere dhe me PC*
- *Certifikimi: EN54-2 dhe EN54-4*

Logjika e funksionimit te sistemit Loop
Para se te filloje instalimi, daljet e planifikuara dhe kerkesa te vecanta duhet te koordinohen me gjendjen ne fakt. Loop nuk duhet te kaloje me shume se 120 paisje. Ai fillon ne central dhe mbyllet ne central. Kabell alarm zjarri 2x1mm^2 duhet te perdoret i shtrire ne tub plastik fleksibel. Specifikimet e kabllit jane si meposhte:

Kabell alarm zjarri

120 minuta rezistent ndaj zjarrit, i mbrojtura (lloji SF), dhe i pambrojtur (lloji RF). Kabell për sistemimin e përhershëm të zjarrit. Shkarkim të paket të halogenit, emetim të ulët të tymit dhe gazrave toksike dhe retardantëve të flakës. I përshtatshëm për instalimet e brendshme në hapësirat publike, edhe në lagësht dhe në natyrë (jo për mjedise të vështira). Mundesi instalimi me kabllo të energjisë elektrike është e lejuar për 450 / 750V dhe 0.6 / 1kV.

1.10 Sistemi i tokezimit dhe i mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike

Sistemi i tokezimit dhe i rrufepritesit do te behet sipas vizatimeve.
Arsyet kryesore për tokëzimin dhe lidhjen në instalimet elektrike janë:

- Për të eliminuar mundësinë e goditjes elektrike të personelit.
- Për të lejuar pajisjet mbrojtëse të funksionojnë në mënyrë të saktë në mënyrë që kohëzgjatja e rrymave të defekteve (lidhjeve te shkurtra) të mbahen në minimum
- Për të barazuar potencialin e tensionit të punimeve metalike normalisht jo-aktuale
- Për të parandaluar ngarkimin elektrostatik të centralit të procesit në lëvizjen e lëngjeve.

Duke qene se eshte perzgjedhur skema e furnizimit TN-C sipas standartit IEC 60364, mqs ne objekt nuk kemi paisje per mundesi ndezje zjarri apo deformim te fushet magnetike atehere menyra e tokezimit dhe e furnizimit do te jete sipas figures se meposhtme:



Skema TN-C

Sistemi i tokezimit duhet te jete me shume se 5 metra nga sistemi i rrufepritsit. Ne rast se vlerat e rezistencave nuk arrine vleren e shenuar ne vizatim atehere duhet te rritet numeri i elektrodave te tokezimit. Mos te realizohet sistemi ku ka kimikate apo materiale te tjera qe ndryshkun materialet e tokezimit. Sistemi i tokezimit duhet te jete 50cm nen siperfaqe. ne hyrje te objektit te vendoset nje

pusese ku te jep mundesine per te bere kontrollet e rezistences se tokezimi. Te gjithe panelet duhet te kene zbare tokezimi. Ne kabinen elektrike duhet te instalohet rrjeti ekuipotencial, nje percjelles Cu 70mm2 i cili vendoset 40cm nga siperfaqja. Pjese e keti percjellesi eshte edhe zbara ekuipotenciale si ne figure ku ne te lidhen te gjithe percjellesit e tokezimit qe lidhen me paisjet. Paisjet brenda kabines nuk duhet te tokezohen me percjelles me te vogel se 70mm2, Cdo pjese metalike ne kabine duhet te tokezohet. Duhet te tokezohet, transformatori, celat, paneli TU, neutri i transformatorit. Rezistenca e tokezimit mbrojtes nuk duhet te jete me shume se 4ohm.

Ne objekt duhet qe cdo panel te kete zbaren e tokezimit. Secili nga panelet duhet te marre tokezimin nga zbara kryesore ne panelin kryesor te godines. Cdo kanaline me talike duhet te kete tokezimin, dhe kanalinat me njera tjetren duhet te lidhen me percjelles tokezimi duke shfrytezuar bulonerite e bashkimit te tyre.

Te gjithe paisjet qe kane furnizim me kabell ushqimime te madh se 35mm^2 duhet te tokezohen me percjelles 70mm^2. Ndersa paisjet e tjera me percjelles 25mm^2 ose 16mm^2.

Elektrode tokezimi

- *Materiali: celik i galvanizuar*
- *Dimesionet L=1500, 50x5x5*

Zbare ekuipotenciale

- *Morsetat:5 x 35 mm2 3 x 50 mm2 1 x 120 mm*
- *Materiali: Baker dhe e paisur me suport plastik.*

Shkeputes per matje

- *Bazament baker*
- *Suport plastik*
- *Bazamnet zinku*

Shkeputes per matje

- *Materiali: Celik i galvanizuar*
- *E paisur me dy vrima 10mm per montim*

- *Diametri 16mm*



Shirit zinku 30x3mm

- *Materiali: Celik i galvanizuar*
- *Densiteti i zingimit: 500g/m2*
- *Densiteti: 0.75kg/ml*

Percjelles Cu 70mm^2

- *Materiali: Baker*
- *Densiteti: 0.625kg/ml*

1.11 Sistemi i menaxhimit te vendeve te parkimit

Sistemi i menaxhimit te parkinkut do jete i tille qe te behet e mundur menaxhimi i vendeve te parkimit per gjendjen e tyre (i zene ose i lire) gjithashtu te behet gjendja totale ne kohe reale e vendeve te lira dhe ato te zena.

Ky sistem perbehet nga keto element :

1-Detektor me ultratinguj (instalimi i sensorit ultrasonik per detektimin ne kohe reale te zenies se vendit te prakimit. Tensioni I ushqyesit 24Vdc. Konsumi: 30mA. Komunikimi: RS-485. Perfshin LED per te treguar gjendjen: te gjelbert - te kuq. Diapazoni i detektimit dhe indikator me shkelqim te rregullueshem me ane te komunikimit ne distance.)

2-Tabele LED per postet e disponueshme ne hyrje te parkimit. (instalimi i tabeles LED per tregimin e nr te vendeve te parkimit. Shikueshmeria nga te dy drejtimet. LED me intensitet te larte. Ngjyra: E kuqe - Blu. Ushqimi: 24Vdc. Konsumi: 100mA.)

3-Konverter RS 485, kontrollues zone (instalimi I konverterit RS485/TCP- IP, me funksionin e perqendrimit ne linje te sistemit te menaxhimit te automjeteve.
Ushqimi: 230Vac. Porte RS485 e izoluar me optociftues. Shpejtesia e komunikimit RS-485: 19,200 baud. Dalja Ethernet 10/100 Mbps. Optomizuar per te ulur kohen e perditesimit te
ekranit.)

4-Detektor me ultratinguj. Per shumatoren hyrje-dalje. (instalimi i sensoreve cift ultrasonik per detektimin e automjeteve. Ushqimi: 24 Vdc. Komunikimi: RS-485. Dallim i drejtimit te kalimit. Limiti I shpejtesise: 15 km/ore. (Numerimi ne hyrje te parkimit))

Ne dy hyrje daljet e parkimit do te instalohen traret automatit ku do kufizohet levizja sipas rregullores se parkimit.
Traret duhet te jene te lidhur me sistemin e biletarise.

TREKËNDËSHI I ZJARRIT

TETRAEDRI I ZJARRIT

RELACIONI TEKNIK
MBI ZBATIMIN E NORMAVE PËR MBROJTJEN NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN PËR OBJEKTIN:

" NDERTIMI I GODINES SE PARKIMIT DHE HAPESIRAVE MBESHTETESE NE BERAT"

1. PJESË E RELACIONIT TË PROJEKTIT ARKITEKTUROR

Objekti: ”Parkimi nëntokësor” te sheshi Teodor Muzaka në Berat përbëhet nga 1 kat parkimi nëntokë. Sipërfaqja totale e katit te parkimit nën tokë është 6406m^2.

Parkimi ndodhet në zonë urbane dhe ka akses të drejtpërdrejtë në rampat hyrëse dhe dalëse të tij për në parkim. Edhe në brendësi të ndërtesës forcat zjarrfikëse dhe të shpëtimit i kanë hapsirat e duhura për të kryer me efektivitet veprimet operacionale në zgjidhje të situatave. Parkimi klasifikohet nëntoksor dhe i mbyllur duke qenë se ndonëse parashikohen hapjet perimetrale për ventilimin natyral në kushte normale të funksionimit, këto hapje janë më të vogla se 60% e sipërfaqes së mureve anësore dhe më të vogla se 4% të sipërfaqes së parkimit.

- **KOMPARTIMENTIZIMI**

Duke qenë se parkimi është i mbyllur sipërfaqja maksimale për një kompartiment zjarri është 2500m^2, e cila dyfishohet me përdorimin e një impjanti të shuarjes automatike të zjarrit. Duke qenë se parashikohet në projektin hidrik të mbrojtjes nga zjarri një impiant “sprinkler” sipërfaqja maksimale e një kompartimenti shkon në 5000m^2. Për këtë arsye kati i parkimit eshte ndare ne dy kompartimente zjarri, njera me siperfaqe 3356m^2 dhe tjetra 3050m^2. Per ndarjen e dy kompartimeve duhet te vendosen porta kundra zjarri me REI 120.

- **LARTËSITË E KATEVE PARKIM**

Lartësitë e katit te parkimit eshte 4m.

- **NUMRI I POSTEVE TË PARKIMIT**

Numri i vendeve të parkimi në katin -1 është 198 poste parkimi automjetesh.

- **VENTILIMI I PARKIMIT NËNTOKËSOR**

Ventilimi mekanik

Impianti i ventilimit te parkimit funksionon mbi baze te qarkullimit te ajrit nepermjet thithjes se ajrit te fresket nga shaftet vertikale ne krahun e djathte toke, thithjes dhe shtytjes se ajrit te ndotur nepermjet ventilatoreve Jet pergjate koridorit dhe xhepave te parkimit dhe shkarkimit te ajrit te ndotur nepermjet ventilatoreve te vendosur ne shaftet vertikale te pjeses tjeter te ketyre kateve. Ventilatoret Jet si dhe ventilatoret te shkarkimit te ajrit te ndotur sherbejne jo vetem per largimin e ajrit te ndotur nga automjetet, por edhe ne raste zjarri per largimin e tymrave te djegies. Keto ventilator komandohen nga Sistemi BMS nepermjet dedektimit te ndotjes se ajrit nga dedektoret e monoksidit te karbonit dhe dedektoret e tymrave te diegies. Sinjalet e ketyre dedektoreve transmetohen dhe ne Centralin BMS dhe ne Centralin e Mbrojtjes Kundra Zjarrit. Ventilatoret e shkarkimit jane dimensionur duke konsideruar nje nderrim ajri prej 10 nderrime ne ore.

2. PJESË E RELACIONIT TË PROJEKTIT KONSTRUKTIV TË MNZSH

Nga ana konstruktive, objekti "PARKIM NËNTOKE" në sheshin "Teodor Muzaka" është projektuar me elementë konstruktive të padjegshëm dhe struktura ndarëse të tipit R90. Edhe ndarjet e kompartimenteve të parkimit me ambjentet teknike do të jenë të tipit jo më të ulet se REI90. Shkallët e largimit do të jenë të realizuar me struktura të padjegshme të tipit të paktën REI120.

Për të rritur garancinë për jetën e njerëzve të pranishëm, kur ata ndodhen në kushtet e një zjarri dhe për të bërë të mundur një evakuim të shpejtë dhe të sigurtë të tyre nga vendi i ndodhjes është e detyrueshme që daljet dhe rrugë kalimet evakuese, sidomos hapsirat dhe kalimet në to të mbahen gjithnjë të lira. Ato bëhen prezent edhe nëpërmjet tabelave treguese fosforeshente dhe me ndriçim.

Në këtë mënyrë, masat e përgjithshme pasive të mbrojtjes nga zjarri përfshijnë edhe:

- pozicionimin e shenjave në vende të dukshme dhe vendosjen e instruksioneve për veprimet që duhet të kryejë personeli në rast zjarri;
- pozicionimin e shenjave që paraqesin pozicionet e fikëseve të zjarrit dhe hidrantëve, rrugët e largimit dhe daljet e emergjencës;
- largimin e materialeve të ndezshme nga ambjentet e parkimit dhe vendosjen e tyre vende të sigurta për parandalimin e transmetimit të zjarrit;
- mbajtjen të lirë të rrugëve të largimit;
- mirëmbajtjen e kujdesshme dhe kontrollin e vazhdueshëm të instalimeve elektrike në përputhje me rregullat përkatëse për instalime të tilla;
- inspektimin nga një personel i kualifikuar dhe trainuar i të gjitha kompartimenteve, magazinave, etj. gjatë gjithë kohës për eleminimin e kushteve që mund të çojnë në krijimin e një zjarri.

3. PJESE E RELACIONIT TË PROJEKTIT MEKANIK TË MNZSH-SË

Në tërësi, duke marrë në konsideratë edhe karakteristikat e ndërtesës si dhe destinacionin e saj, janë përdorur substanca shuarëse si më poshtë :
- sistem stacionar automatik i shurjes së zjarrit (sprinkler);
- sistem i mbrojtjes nga zjarri me ujë, me hidrantë të brendshëm;
- fikës portabël në të gjitha pozicionet e treguara në projekt.

- **FIKËSIT PORTABËL**

Faktorët përcaktues që duhen marrë në konsideratë gjatë projektimit të mbrojtjes aktive nga zjarri kanë qenë:

- Natyra dhe përmasa e zjarrit dhe madhësia e zonës që do të mbrohet
- Mundësia e përhapjes me shpejtësi e zjarrit;
- Kërkesat dhe normat sipas UNI 10779 si dhe ato që janë në fuqi në Shqipëri. Në projekt janë përcaktuar me saktësi edhe zonat që kanë lidhje me klasat e zjarrit si dhe vendet ku janë

vendosur fikësit portabël të zjarrit. Fikësit e zjarrit portabël me pluhur EN3 do të jenë të klasës 34A 233BC.
Shuarësit e zjarrit portabël do të mirëmbahen dhe testohen të paktën në çdo vit nga autoritete të liçensuara për këtë qëllim. Në ambjentin "kabina elektrike" është parashikuar vendosja e një fikësi zjarri me CO_2.

- **NUMRI I FIKËSVE PORTABËL**

Numri i fikësve portabël është përcaktuar konsideruar:
- 1 fikës portabël për çdo 5 automjete, për 20 automjetet e parë;
- 1 fikës portabël për çdo 10 automjete për 200 automjetet e tjerë. Kështu, për çdo kompartiment ku parashikohen 97 automjete për njerin dhe 101 automjete për te dytin numri i fikësve portabël rezulton i njëjtë 14 fikës portable. Në këtë mënyrë, në projekt janë parashikuar 14 fikëse portable me pluhur, pesha 6kg, tipi 55A 233BC. Llogariten në këtë numër edhe fikësit portabël që vendosen në të njëtën kasetë me hidrantin UNI45. 1 fikese zjarri me CO_2 5 kg dhe 3 fikese karelato me pluhur 50kg.

Fikse 5kg me (CO_2)

Fikse 6kg me pluhur

Fikse karrel 50 kg me pluhur

4. PJESE E RELACIONIT TË PROJEKTIT ELEKTRIK TË MNZSH-SË

Projektimi, prezenca dhe mbajtja në gadishmëri pune e sistemit elektrik, ndriçimit të rrugëve të evakuimit, përceptimit të zjarrit dhe sistemeve paralajmëruese të instaluara në godinë janë të nevojshme për t`u mos dëmtuar njerëzit që gjenden në parkim në rast zjarri apo në çdo lloj rasti emergjence, për të parandaluar panikun, për të mundësuar boshatisjen e parkimit dhe për të siguruar një ambient të sigurtë. Për çdo pajisje elektrike është kusht që të projektohet dhe të

ofrohet në përputhje me standartet dhe rregulloret e sistemeve të ndriçimit të rrugëve të evakuimit, orientimit, ndriçimit në rastet emergjente, përceptimit të zjarrit dhe sistemit të paralajmërimit. Energjia e të gjithë sistemeve dhe pajisjeve që përdoren në kuadrin e skenarëve të zjarrit në parkim apo tërmeteve, do të ndahet e veçantë si "energji për raste emergjente" dhe do të trajtohet nëpërmjet paneleve të veçantë. Energjia e parashikuar jashtë këtij kuadri duhet të jetë e ndarë dhe e gatshme për t`u ndërprerë në mënyrë manuale kur kërkohet.
Elementët ku nevojitet energji emergjence do të jenë si më poshtë:
- pompat e sistemit të mbrojtjes nga zjarri;
- energjia që ushqen sistemet e detektimit të zjarrit, të sistemeve të kontrollit të sigurisë;
- sistemi i thirrjes për raste emergjence dhe njoftimet flash nëpër kate (sirenat flash dhe ato të alarmit).

- **DETEKTORET E ZJARRIT**

Në projektin elektrik duhet te parashikohen përdorimi i detektorëve të temperaturës, detektorëve të tymit, detektorëve të gazit karbonik dhe detektorëve të benzinës. Detektorët do të jenë të adresueshëm dhe do të vendosen në pozicionet e përcaktuara nga projekti përkatës elektrik. Gjatë projektimit është pasur parasysh mbulimi i të gjitha sipërfaqeve me detektor sipas normave euriopiane për Sistemet Kundra Zjarrit (EN54)

- **SINJALISTIKA DHE NDRICIMI I EMERGJENCËS**

Tabelat e sinjalistikës duhet të jenë në përputhje me normat UNI 7543 DIN 4818 dhe në përputhje me direktivat CEE dhe normat 150/80. Ato do të jenë të tipit luminishente të realizuara në laminat plastik me spesor 3mm, fotoluminishente dhe të tipit fosforeshent. Dimensionet minimale të tabelave të sinjalistikës do të jenë 250x250mm për tabelat kuadratike dhe 320x250mm për tabelat drejtkëndore.

5. PJESË E RELACIONIT TË PROJEKTIT HIDRIK TË MNZSH-SË

Sikurse përmendëm më parë, impjanti hidrik i mbrojtjes nga zjarri përbëhet nga:
- impjant i stacionar i fikjes automatike të zjarrit ("sprinkler");
- hidrante të brendshëm.

Faktorët përcaktues që janë marrë në konsideratë gjatë projektimit janë natyra dhe permasa e zjarrit, madhësia e zonës qe do të mbrohet, mundësia e përhapjes me shpejtësi e zjarrit, kërkesat dhe normat sipas EN12845 si dhe ato që janë në fuqi në Shqipëri. Impjanti i mbrojtjes nga zjarri parashikon edhe lidhjen jashtë me grupet e specializuara të PNMZSH, në përputhje me normën UNI 11779 PN12.

- **IMPJANTI I SHUARJES AUTOMATIKE TË ZJARRIT TIPI "SPRINKLER"**

Ambjentet e parkimit publik klasifikohen në kategorinë OH2 konsideruar rrezikun ndaj zjarrit (Ordinary Hasard 2) bazuar në normën EN 12845. Impjanti i shuarjes automatike të zjarrit është

projektuar i tipit “i lagur” duke patur parasysh temperaturat e ulta të moderuara të qytetit të Tiranës. Hedhësit e ujit (sprinkler) do të jenë të tipit me element termosensibël. Densiteti minimal të projektimit prej 5.0 l/min/m^2 së cilës i korrespondon një faktor nominal K=80. Zona maksimale e mbulimit nga një sprinkler do të jetë 12m^2; distanca maksimale për një vendosje kuadratike 4m. Madhësia e zonës operacionale rezulton 144m^2, për impjantin e tipit “te lagur”. Kapaciteti i rezervës së ujit të impjantit sprinkler për një kohëfunksionimi prej 60 minuta (OH2) është 43.2m3.
Impjanti sprinkler parashikon një grup alarmi, pavarësisht faktit se sipërfaqja e çdo kati parkim është e limituar kundrejt sipërfaqes maksimale të mbulueshme nga një grup alarmi.

- **Kokat automatike “sprinkler”**

Kokat sprinkler do të jenë të tipit konvencional, me difuzor nga poshtë, me lidhje të shkrijshme me sferë prej çeliku inoksidabël. Ato do të jenë të taruara në temperaturën mesatare 68°C; përmasa e tyre do të jetë DN15.
Në çdo sprinkler duhet të jenë të shënuara qartë karakteristikat e mëposhtme:
- marka e fabrikës;
- modeli;
- tipi i shpërndarjes;
- temperatura nominale e tarimit (nëpërmjet ngjyrës);
- viti i prodhimit.

- **Stacioni hidraulik i kontrollit të alarmit**

Stacioni hidraulik i kontrollit të alarmit do të jetë i përbërë nga një valvol alarmi prej gize me lidhje me flanxha dhe do të jetë i kompletuar me:
- manometër të kontrollit të presionit të ujit i kompletuar me rubineta 1/2”;
- rubinet mashkull bronxi me diametër 3/4”;
- rubinet mashkull bronxi me diametër 1/2”;
- kondravalvol bronxi me diametër 3/4”;
- këmbanë alarmi të tipit hidraulik e lidhur me valvolën e alarmit nëpërmjet një tubi me rubinet prove;
- valvol kryesore të shkarkimit e pajisur me tub shkarkimi prej çeliku të zinkuar dhe pajisjet e provës së ushqimit;
- valvol ndërprerëse kryesore;
- presostat për rregullimin elektrik-optik të alarmit në distancë.

Valvolat e alarmit do të jenë të aprovuara nga FM, UL, CII, FOC.

- **IMPJANTI HIDRIK – RRJETI I HIDRANTËVE**

Rrjeti i hidrantëve është i përbërë nga rrjeti i tubacioneve dhe hidrantë UNI 45;
në katin e parkimit janë pozicionuar shtate hidrantë UNI45. Pozicionet e hidrantëve janë pranë hyrje/dalje në çdo kat të parkimit si dhe në ato pozicione që mundësojnë që çdo pozicion në parkim të mund të mbulohet nga hidrantët. Linjat e furnizimit të hidrantëve janë dimensionuar për të garantuar punën e njëkohshme të 4 hidrantëve të brendshëm UNI 45, në pozicionet më të disfavorshme, duke garantuar një prurje në çdo hidrant të jashtëm prej 120l/min, me një presion mbetës në hidrant prej 2-3bar; gjatësia e tubave të hidrantëve të brendshëm është 30 m. Në 5 nga hidrantët në çdo kat janë parashikuar të vendosen në kaseta të shoqëruar me shuarës zjarri portabël me 34A 233BC.
Kasetat e hidrantëve të brendshëm janë vendosur në pozicion të dukshëm dhe e pajisur me sinjalistikën përkatëse. Lëshuesi dhe tubacioni i ujit janë vazhdimisht të lidhura me kolonat e furnizimit me ujë. Kapaciteti i rezervës së ujit të impjantit te hidranteve per nje kohe funksionimi prej 60 minuta (OH2) është 28.8 m3

Hidrantët do të jenë të përbërë nga:
- rubinet hidranti prej bronxi UNI 45 me përmasë 1 ½" (UNI 811);
- tubacion i hidrantit i tipit "extra forte" prej tubi me fibra poliester, mbi shtresë impermeabel gome me riveshje të jashtme rezine PVC kundër konsumimit me përmasë 45mm dhe gjatësi 30m;
- 3 rakorde të zinkuara UNI 804 dhe 811 për lidhjen me tubacionin dhe hedhësin;



- **TUBACIONET DHE RAKORDERITË**

Tubacionet dhe rakorderitë që do të përdoren do të jenë në përputhje me normativat e mëposhtme: - tubacione çeliku S235JR dhe Fe360 sipas UNI 10025, UNI EN 10029;
- brylat, kthesat dhe trashësite e mureve sipas UNI EN 10024;
- mbërthyesit dhe vida/bulona CE, sipas UNI 5727;
- manikotat antivibrantë me flanxha çeliku sipas UNI EN 1092-1;
- lyerja e jashtme kundër korrozionit me sprucim (Catramina HD), me spesor minimal >=150 mikron, referuar UNI 12845;
- lyerja në zonën e ujit kundër korrozionit nëpërmjet sprucimit të catrame epossibituminoz bicomponente EPOXITAR, me spesor minimal >=150 mikron, referuar UNI 12845;
- lyerja në zonën teknike me antiruge dhe trajtim i metejshëm me epossidoc bicomponent EPOX i Zinkuar, në përputhje me UNI 11292.

- **MBËSHTETESET E TUBACIONEVE**

Mbështeteset do të jenë prej materialesh rezistentë ndaj zjarrit dhe të tilla që të mbajnë pa deformime një ngarkesë minimale prej 100kg mbi 5 fishin e peshës së tyre të mbushura me ujë. Forma e tyre do t'i referohet normës UNI 7145. Mbështeteset e tubacioneve do të studiohen nga kontraktori dhe do t'i paraqiten për aprovim supervizionit të punimeve së bashku me vizatimet konstruktive.
Përmasimi i suporteve do të marrë në konsideratë:
- peshën e tubacioneve, valvolave, rakordeve dhe në përgjithësi të të gjithë komponentëve të varur;
- sforcimet e krijuara nga lëkundjet sizmike, provat hidrostatike, grushtet hidraulike dhe ndërhyrjes së valvolës së sigurisë;
- sforcimet e krijuara nga dilatacionet termike;

Pozicioni i mbështetëseve do të zgjidhet mbi bazën e:
- përmasës së tubacioneve;
- rrugë kalimeve të tyre;
- prezencës së ngarkesave të koncentruara (pompa, valvola, etj.); - strukturës së disponueshme për mbërthim;
- lëvizjeve të dilatacionit termik.

- **GRUPI I LIDHJES ME BRIGADAT MKZ**

Nga kolektori shpërndarës MNZ në ambjentin teknik jane parashikuar dy pika lidhje me brigadat e specializuara PNMZSH, të pajisura me dispozitivin përkatës, në afërsi të hyrjes në parkim.
Lidhja do të përfshijnë:
- no.1 dalje për lidhje UNI 70 në përputhje me normën UNI 808, me diametër jo më të vogël se DN70, të mbrojtura nga futja e trupave të huaj në to;
- no.1 valvol ndërprerëse e cila lejon ndërhyrjen në komponentët e saj pa qenë e nëvojshme të zbrazet impjanti;
- no.1 valvol moskthimi;
- no.1 valvol sigurie e taruar në 1,2Mpa (12bar) për kontrollin e mbipresionit nga pompa. Njëkohesisht, në të dy shkallët e largimit në cdo kat janë parashikuar një valvola DN65 ("Landing Valve") për lidhjen e brigadave PNMZSH me rrjetin e hidranteve.

- **GRUPI I POMPIMIT TË IMPJANTIT KUNDËR ZJARRIT**

Grupet e pompimit të impjantit kundër zjarrit do të vendoset në ambjentin teknik në katin nëntokë dhe do të jetë në përputhje me normativen EN 12845. Keto grup do t'i shërbejne njeri impjantit "sprinkler" ndersa tjetri rrjetit të hidrantëve.

Grupi i pompimit te sprinklerave do të përbëhet nga 3 pompa:
- 1 pompë pilotë (84 l/min, 5 bar);
- 1 pompë elektrike e shërbimit (720 l/min, 4.7bar) si edhe
- 1 motopompë shërbimi (720 l/min, 4.7bar)

Grupi i pompimit te hidranteve do të përbëhet nga 3 pompa:
- 1 pompë pilotë (84 l/min, 5 bar);
- 1 pompë elektrike e shërbimit (480 l/min, 4.5bar) si edhe
- 1 motopompë shërbimi (480 l/min, 4.5bar)

Pompa pilotë do të mbajë sistemin e presuar duke përballuar humbje të vogla presioni, duke parandaluara hyrjen në punë të pompës kryesore për ripresim dhe duke parandaluar alarme të reme. Pompa pilotë do të kontrollohet automatikisht.
Në raste zjarri, me rënjen e presionit në rrjetin kundër zjarrit nën një nivel të caktuar, kontrollori elektronik do të aktivizojë automatikisht pompën elektrike të shërbimit si edhe të transmetojë një sinjal zjarri në sinjalizuesit vizuale.
Në rast se pompa elektrike e shërbimit nuk staron për cfarëdo arsye, motopompa „stand-by" hyn në funksion brenda 15 sekondash. Funksionet e saj janë të njëjta me funksionet e pompës elektrike kryesore të sherbimit, por shërben si një rezerve në rast mosfunksionimi të pompës elektrike të shërbimit. Kjo pompë duhet të ketë një rezervë diesel për funksionimin 4 orë. Impjantet do të funksionojnë si në mënyrë automatike ashtu edhe manuale. Shkarkimi i gazrave të motopompës, lidhja fleksibel motor/tubacion sipas UNI 11292; izolimi termik dhe mbrojtja e personave nga kontakti me të nëpërmjet një kapote PROMAFLEX sipas UNI 11292;



- **SASIA E UJIT**

Sasia e ujit që kërkohet është e barabartë me kërkesat për ujë të vazhdueshëm për shuarjen e zjarrit si dhe kohën në dispozicion që duhet për eliminimin e tij. Kjo sasi përcakton depozitën e nevojshme të ujit në dispozicion për mbrojtjen nga zjarr për një autonomi prej 1 orë të impjantit të shuarjes autmatike të zjarrit (rreth 113,500 litra ose 113.5m^3 në dispozicion të impjantit MKZ+15.500 litra ose 15.5m^3 per furnizim me uje sanitar). Rezervuari B/A duhet të pajiset me tregues niveli elektronik si edhe mekanik vizual, të cilët duhet të sinjalizojnë për rënjen e nivelit të ujit në rezervuar nën një vlerë të përcaktuar. Ky sinjal duhet t'i transmetohet panelit qëndror të komandimit te grupit të pompimit dhe nëpërmjet saj sinjalizuesve përkatës. Përdoruesi duhet të garantojë edhe zëvendësimit e here pas hershëm të kësaj rezerve nëpërmjet përdorimit të saj për qëllime sanitare.

- **PROVAT E TUBACIONEVE TË FURNIZIMIT ME UJË**

Provat e tubacioneve të furnizimit me ujë do të realizohet sipas operacioneve të mëposhtme:
- verifikimi i përputhshmërisë së instalimeve me projektin përkatës ekzekutiv;
- verifikimi i përputhshëmrisë së komponeteve të përdorur në normativat e paraqitura në normën UNI 10779;

Provat e tubacioneve do të realizohen si më poshtë:
Pastrimi i tubacioneve
Pas vendosjes së tyre, tubacionet do të pastrohen plotësisht me uje me një shpejtësi jo më të vogël se 2m/sec.

Testimi i rrjetit të furnizimit me ujë.
Përpara testimit të cdo linje, kontraktori duhet të siguroje që ai është mbërthyer në mënyrë të përshtateshme dhe goditjet në bryla ose degëzime apo fundet e tubacioneve transmetohen në tokë ose në struktura të përshtateshme të mbërthimit. Fundet e tubacioneve do të mbyllen me kapake dhe flanxhat mbyllëse do të jenë të shtrënguara. Kontraktori do të realizojë punën dhe do të sjellë pajisjet e testimit (përfshirë tubacione shtesë, material bashkues dhe fllanxha mbyllëse); ai do të mbushë tubacionet me ujë dhe do t'i zbrazë ato pas provave, gjithshka me aporvimin e kolaudatorit.

Testimi i tubacioneve do të përfshijë:

- provën hidrosataike e tubacioneve do të realizohet për 2 orë me një presion minimal prej 1,5 herë presionin e punës i impjantit;
- verifikimin e fluksit të rregullt në kolektor gjatë aktivizimit të hidranteve;
- verifikimin e kushteve të projektit referuar prurjes dhe presionit minimal që duhet garantuar;
Kolaudimi do të kryhet në përputhje me normën UNI 9490.

6. PJESE E RELACIONIT PËR SKEMAT E EVAKUIMIT

Numri i personave në parkim është llogaritur 0,05 persona/m2 të cdo kompartimenti. Në këtë mënyrë numri i personave rezulton 167 persona për kompartimentin e pare dhe 152 persona per te dytin. Në sejcilin kompartiment janë projektuar nga arkitekti 1 shkalle largimi emergjence spirale; largimi në rast emergjence bëhet edhe nga hyrja në parkim (me gjerësi 6 m e cila është vazhdimisht e hapur). Shkallet e largimit të emergjences duhet te jenë shkallë të mbrojtura me dyer antizjarr REI120 të tipit me vetëmbyllje. Gjerësia e dyerve të largimit te emergjencës është 1.3m. Shkallët antizjarr kanë dalje direkte të hapur në sheshin "Teodor Muzaka". Shkallet e emergjencës duhet te jenë të arritëshme nga cdo pozicion për një distancë më të vogel se 50m, vlerë kjo brenda normave të lejuara duke qëne se parkimi është i pasjisur me një impjant të shuarjes automatike të zjarrit).

Plani i evakuimit:
Skemat e evakuimit duhet te afishohen ne vende te dukshme dhe me ate duhet te njihen te gjithe personat qe jetojne aty.
Ky plan duhet te zbatohet dhe nga vizitoret qe mund te vijne ne objekt

FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
ALBANIAN DEVELOPMENT FUND

EBS
ENGINEERING CONSULTANCY

Godina e Parkimit dhe Hapësirave Mbështetese në Berat

RAPORT MBI KUSHTET GJEOLOGO-INXHINIERIKE

Qershor 2020

PERMBAJTJA

1. HYRJE 3

2. ZONA E PROJEKTIT DHE GJENDJA EKZISTUESE E SHESHIT PER INVESTIGIM GJEOLOGJIK 4

3. TERMAT E REFERENCES, OBJEKTIVI DHE QELLIMI DHE SHERBIMET E KERKUARA 7

3.1 OBJEKTIVI I STUDIMIT 7
3.2 QELLIMI I STUDIMIT GJEOLOGJIK 7
3.3 SHERBIMET E KERKUARA 7

4. GJEOLOGJIA E MAKROZONES, GJEOMORFOLOGJIA DHE GJEODINAMIKA 8

4.1 NDERTIMI GJEOLOGJIK I MAKROZONES KU PERFSHIHET ZONA E PROJEKTIT 8
4.1.1 Depozitimet deluvialo-aluviale 8
4.1.2 Depozitimet paleogjenike 8
4.2 GJEOMORFOLOGJIA DHE HISTORIKU U SAJ 9
4.3 FENOMENET GJEODINAMIKE 10
4.4 RREZIKU SIZMIK NE ZONEN E PROJEKTIT 11
4.5 KUSHTET HIDROGJEOLOGJIKE 13

5. KUSHTET GJEOLOGO-INXHNIERIKE TE TRUALLIT TE PROJEKTIT 13

5.1 POZICIONI I SHPIMEVE NE SHESHIN E PARKIMIT NENTOKESOR 13
5.2 PROCESI I SHPIMIT DHE MARRJA E KAMPIONEVE PER TESTET LABORATORIKE 14
5.3 NDERTIMI I KOLLONAVE TE SHPIMIT DHE PRERJES LITOLOGJIKE TE ZONES SE NDERTIMIT TE PARKIMIT 14
5.4 REZULTATET E TESTEVE NE TERREN DHE LABORATOR TE FORMACIONEVE DHE SHTRESAVE TE HASURA NE SHESHIN E NDERTIMIT ... 14

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME 17

LISTA E FIGURAVE

Figure 2-1 Sheshi i ndertimit te Parkingut nentokesor - Berat 5
Figure 2-2 Projekti i ardhshem mbi Parkingun nentokesor me hapesirat mbeshtetese - Berat 6
Figure 2-3 Sheshi Teodor Muzaka dhe godinat rreth tij 7
Figure 4-1 Harta gjeologjike e zones se Beratit 9
Figure 4-2 Harta e zonimit sizmik te Republikes se Shqiperise 12
Figure 5-1 Pozicioni ne plan I pikave te shpimit 14

LISTA E TABELAVE

Table 4-1 Niveli I ujrave nentokesore ne shpimet e kryera 13
Table 5-1 Pikat e shpimit dhe pozicioni I tyre ne plan 13

1. HYRJE

Sipas kerkeses se bere nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, gjate muajt Qershor 2020, u be studimi mbi kushtet gjeologo – inxhinierike te sheshit te ndertimit te Objektit: Godina e Parkimit dhe hapesirave mbeshtetese ne Berat. Pasi u be nje rikonicion i hollesishem ne terren nga autoret e studimit dhe pala prefituese (Bashkia Berat), duke pare faktoret gjeologjike, gjeomorfologjike, hidrogjeologjike e gjeologo-inxhinierike ne shesh, u vendos qe studimi te behet me shpime te vendosura ne kufinjte e sheshit te projektit, per te patur perfundime perfaqesuese per te gjithe zonen e nderteses se parkimit, rikonicion gjeologjik dhe dokumentim te zonave te germuara ne kufi me zonen e projektit dhe rreth saj. Njekohesisht u shfrytezuan dhe materiale gjeologjike arkivale te bera per studimin e objekteve te ndryshme ne kete zone, nga autori i studimit dhe studiues te tjere. Punimet fushore u kryen me autosonde me rrotullim, me marrje kampioni, me diameter shpimi Φ = 110 mm. Njekohesisht me punimet me autosonde u be dhe rilevimi gjeologjik i zones per te evidentuar hollesisht dhe fenomenet gjeodinamike ne shesh dhe zhveshjet natyrale, me qellim qe te orientohen sa me mire vendet e kryerjes se shpimeve. Gjate procesit te shpimit u moren kampione me strukture te prishur e te paprishur per çdo shtrese dhe thuajse ne te gjitha shpimet. Keto kampione u derguan per analiza laboratorike ne Laboratorin e dherave dhe te shkembit SARP & LAB ne Durres. Njekohesisht u bene dhe prova ne terren me aparatin Standart Penetration Test (S:P:T) per çdo shtrese gjeologo–litologjike. Te dhenat jane pasqyruar ne kapitullin e kushteve gjeologo-inxhinierike. Gjate procesit te shpimit ne çdo sonde u verejt me kujdes dhe gjendja e ujrave nentokesore, niveli i te cilave u mat pas 24 oreve. Kuotat e te gjitha sondave jane relative kundrejt siperfaqes se tokes. Te dhenat e marra nga procesi i shpimit jane pasqyruar edhe ne kollonat litologjike dhe prerjet gjeologo – litologjike. Ky studim mendojme se eshte i plote, megjithate autoret e studimit eshte i mendimit se shume gjera dhe fenomene mund te sqarohen dhe korigjohen edhe gjate zbatimit te objekteve (ne fazen e germimit te gropes se themeleve).

Studimi mbi kushtet gjeologo inxhinierike te sheshit ku eshte parashikuar te ndertohet Parkingu dhe hapesirat mbeshtetese ne Berat ka si objektiv sigurimin e te dhenave dhe parametrave te domosdoshem gjeologjike dhe gjeoteknike per hartimin e projetit te zbatimit te tij si dhe percaktoje menyren e germimeve dhe menaxhimin e ujrave nentokesore gjate ndertimit te tij.

Studimi eshte marre persiper nga Kompania E.B.S Shpk nepermjet kontrates se lidhur me Fondin Shqiptar te Zhvillimit me date 22.05.2020.

Mbi bazen e te dhenave te kushteve gjeologo-inxhinierike te zones se Beratit ne pergjithesi dhe zones se projektit te Parkingut ne vecanti, Studimit te zones se projektit nepermjet shpimeve te puseve si dhe testeve laboratorik te kampioneve te marre gjate shpimeve, kerkohet te hartohet nje raport gjeologjik dhe gjeoteknik ku te perfshihen por jo te kufizohet:

- Kushtet gjeomorfologjike te zones se projektit
- Kushtet gjeologo-inxhnierike te terrenit ku do te ndertohej Parkingu nentokesor

- Kushtet hidrogjeologjike te zones se projektit
- Parametrat gjeologjike dhe gjeoteknike te tokes dhe nentokes te zones se projektit nepermjet testeve ne terren dhe laboratorin gjeoteknik

Aktivitetet per hartimin e studimit gjeologjik filluan me viziten ne zonen e projektit, kontaktin me autoritetet lokale, percaktimin e pikave te shpimit qe te ishin perfaqesuese per zonen e projektit dhe mobilizimin e mjeteve dhe stafit per fillimin e shpimeve ne terren. Me date 01.06.2020 filloi shpimi sipas pozicioneve te percaktuara ne zonen e projektit.
Pas investigimeve ne terren nepermjet shpimit te pese puseve me thellesi 12 m, testeve ne terren dhe marrjes se kampioneve, jane realizuar provat laboratorike dhe nxjerre parametrat gjeologjike dhe gjeoteknike.
Ne baze te gjithe aktiviteteve ne terren dhe laboratore eshte hartua ky raport si kerkese baze e Termave te References.

2. ZONA E PROJEKTIT DHE GJENDJA EKZISTUESE E SHESHIT PER INVESTIGIM GJEOLOGJIK

Zona e projektit per studim gjeologo-inxhinierik dhe gjeoteknik eshte sheshi “Teodor Muzaka” ne qender te qytetit te Beratit, Figure 2-1.
Projekti BID ka investuar ne rehabilitimin e infrastructures se sheshit dhe bulevardit “Republika”, duke e shnderruar ate ne nje zone me eprdorim kembesor dhe biznesi, te perdorur nga banoret vendas dhe turistet sin je pike referimi per te orientuar turistet drejt nje rrjeti zonash kulturore, restorante dhe aktivitete biznesi. Gjithashtu zona ka filluar te prese panaire tregetare, ngjarje, panaire artizanalesh, aktivitete kulturore, etj.
Ne qender te qytetit jane vendosur institucionet kryesore shteterore dhe private, te cilat gjallerojne jeten e tij me aktivitete te shumta social-ekonomike dhe kulturore. Institucionet perfshijne Prefekturen, Keshillin vendor, Bashkine Berat, Zyren e regjistrimit te Pasurive, Zyren e Punesimit, Bankat, Polikliniken mjekesore te qytetit, Shkollen e mesme si dhe institucionet fetare si Xhamine dhe Katedralen Orthodokse.
Sheshi “Teodor Muzaka”, ku eshte parashikuar te ndertohet Parkimi nentokesor permban tenda ngjarjesh dhe eventesh, peme dekorative, shesh lojrash per femije dhe nje pike informimi per vizitoret. Siperfaqja e propozuar per pozicionimin e parkimit nentokesor eshte afersisht 7,600 m^2. Projekti i parashikuar mbi ndertesen e Parkingut nentokesor dhe hapesirave mbeshtetese ne Berat jepet ne Figure 2-2 qe vijon ndersa ne Figure 2-3 jane dhene projekti dhe objekte rreth sheshit te projektit.

Figure 2-1 Sheshi i ndertimit te Parkingut nentokesor - Berat

Figure 2-2 Projekti i ardhshem mbi Parkingun nentokesor me hapesirat mbeshtetese - Berat



Figure 2-3 Sheshi Teodor Muzaka dhe godinat rreth tij



3. TERMAT E REFERENCES, OBJEKTIVI DHE QELLIMI DHE SHERBIMET E KERKUARA

3.1 OBJEKTIVI I STUDIMIT

Percaktimin e parametrave gjeologjike dhe gjeoteknike per nje projektim dhe ndertim te qendrueshem te projektit: “Ndertim I godines se Parkimit dhe hapesirave mbeshtetese ne Berat” si pjese e rendesishme e zhvillimit te qendres se qytetit te Beratit, I cili do te bejet te mundur lehtesimin e levizjes se mjeteve per vete banoret dhe turistet vendas dhe te huaj duke rritur potencialin ekonomik dhe turistik te qytetit te Beratit.

3.2 QELLIMI I STUDIMIT GJEOLOGJIK

Qellimi I studimit eshte pregatitja e nje raporti gjeologjik ne baze te njohjes se kushteve gjeologjike, gjeomorfologjike dhe hidrologjike te truallit si dhe qendrueshmerine e tij ne te gjithe zonen ku do te ndertohet Parkimi nentokesor dhe zones perreth.

3.3 SHERBIMET E KERKUARA

Bazuar ne Termat e References kerkohet:

- Studim I gjeologjise rajonale ku ben pjese zona e projektit
- Studimi sizmik I zones dhe kategorizimi I saj
- Shpimet ne zonen e projektit sipas nje planifikimi perfaqesues te saj

- Testimi ne terren, marrja e kampioneve per analiza laboratorike te detajuara
- Analizat laboratorike dhe percaktimi I parametrave gjeologjike dhe gjeoteknike
- Sistemimi I te dhenave dhe rezultateve te investigimit dhe hartimi I raportit gjeologjik
- Konkluzione dhe rekomandime per germimet dhe menaxhimin e ujrave nentokesore perfshire mbrojtjen e skarpatave gjate ndertimit.

4. GJEOLOGJIA E MAKROZONES, GJEOMORFOLOGJIA DHE GJEODINAMIKA

4.1 NDERTIMI GJEOLOGJIK I MAKROZONES KU PERFSHIHET ZONA E PROJEKTIT

Ne zonen tone te studimit dhe pergjithesisht ne te gjithe zonen e lugines se Osumit deri ne ultersiren perendimore kemi depozitimet deluviale-aluviale Kreatike, Neogjenike dhe Paleogjenike. Harta gjeologjike pjesore e zones se Beratit eshte dhene ne Figure 4-1, ndersa Harta e plote gjeologjike e zones eshte dhene ne ***Aneksin 1***.

4.1.1 Depozitimet deluvialo-aluviale

Depozitimet deluvialo-aluviale jane produkti i coptimit dhe te tjetersimit deri ne rrumbullakosje dhe produkte te imeta te depozitimeve shkembore Kretake dhe neogjenike. Ato jane ne forme suargjilash deri surera me ngjyre kafe. Poshte pjeses deluviale jane aluvionet e lumit Osum te cilat perfaqesohen nga zhavore gelqerore koker vogel deri koekr mesem dhe rera ngjyre gri.

4.1.2 Depozitimet paleogjenike

Depozitimet Paleogjenike perfaqesohen nga ranore, alevrolite ne ngjyre gri te kalter dhe bezhe ne pjesen e siperme te perajruar ,jane me çimentim. Keto depozitime ndertojne kodrat perreth Beratit sidomos pjesen veriore dhe kane si mbulese aluvionet dhe deluvionet ne pjese e trase se. Ne pjesen e zones tone ato mund te hasen mbas 18 m zhavore te lumit Osum.

Figure 4-1 Harta gjeologjike e zones se Beratit



4.2 GJEOMORFOLOGJIA DHE HISTORIKU U SAJ

Ultesira perendimore perfshin terrenet e Ultesires paramalore e cila ka pasur nje tendence zhytje te pergjithshme gjate etapes neotektonike dhe vetem ne mbarim te kesaj etape dhe fillimit te kuaternarit, ajo del nga uji e i nenshtrohet ngritjes. Ultesira sot ka tendence ngritje dhe kete e deshmon zhvendosja e vijes bregdetare per nga Perendimi, por ne te ka dhe sektore te veçante me tendence zhytje. Mbas tektogjenezes si rezultat i zhytjes se pjeses Adriatike nen Orogjenin ndermjet terhoreve Shkoder-Peje e Vlore-Tepelene u formua Ultesira Paramalore (nga Tortoniani). Ne kete Ultesire deti vershoi nga Veri-Veriperendimi ne Lindje-Juglindje duke vendosur mbi pjesen Jonike dhe sektoret verior te Zones Kruja. Ne sektoret perendimore te ultesires pellgu eshte mjaft i thelle dhe ne te u depozituan sediment argjilore me trashesi rreth 3000m me foraminifere planktonik. Ne sektoret lindore ne drejtim te bregut sedimentet terrigjene jane depozituar ne zona te cekta prane bregdetare dhe kane material trashaman me foraminifere bentosik. Ardhjet e materialit kane qene kryesisht nga Lindja. Lidhja e pellgjeve te ultesires paramalore eshte kryer kryesisht nepermjet vershimit te detit. Gjate Mesinianit ne Ultesiren Paramalore deti terhiqet dhe verehet rritja e kripshmerise nga Lindja ne drejtim te Perendimit dhe ne nje det te mbyllur te te gjithe treves mesdhetare u krijuan kushtet per formimin e evaporiteve. Ne Pliocenin e poshtem verehet perseri nje faze rudhosje qe formon strukturat e Ultesires Paramalore dhe qe ndjehet ne zonat e brendshme. Si te gjithe trevat mesdhetare dhe Ultesira Paramalore ne Pliocen te Poshtem peson zhytje dhe deti shtrihet drejt Lindjes. Sedimentet ne sektoret lindor jane pranebregdetar, kryesisht konglomerato-ranore dhe drejt perendimit pelagjike me material alevrolitik e argjilor dhe foraminifere planktonik. Ne fund te Pliocenit ne Ultesiren Paramalore mbizoterojne seri regresive qe karakterizohen me pakesimin e foraminifereve planktonike dhe mbizoterimin e gjinise Ammonia. Pellgu detar Adriatiko-Jonik u krijua ne Pliocen-Kuaternar si pasoje e zhytjeve qe ndodhen ne kete pjese kur pjesa tjeter me ne lindje u kthye ne kontinent.

Depozitimet Kuaternare kane perhapje relativisht te madhe ne vendin tone, ato mbulojne pjeserisht si zonat tektonike te brendshme, ashtu dhe ato te jashtme. Kryesisht mbulojne pjesen e ulet bregdetare. Stratigrafia e pjeses Kuaternare ne Shqiperi eshte akoma jo e studiuar mire. Depozitimet kuaternare jane ndare vetem nga pikepamja morfogjenike duke dalluar vec depozitimeve pliocenike kuaternare dhe depozitimet aluviale, proluviale, koluviale, deluviale akullnajore, kenetore, liqenore dhe detare. Ne disa raste jane te nderthurura me njera tjetren dhe formojne tipe gjenetike te perziera si aluviale-proluviale, liqenore-proluviale, detaro–kenetore(lagunore), aluviale-kenetore, etj.

Pershkrimi i ketyre depozitimeve jepet si me poshte vijon:

a) Depozitimet te pliocenit te siperm- kuaternarit te vjeter (N2-Q1).
b) Depozitimet e kuaternarit te poshtem te mesem dhe te siperm te pandara (Q1-3)

4.3 FENOMENET GJEODINAMIKE

Nga fenomenet me kryesore dinamike qe sjellin problem qendrueshmerie që kërcënojnë zonat
E luginave dhe tarracave lumore janë:

- Rrëshqitjet,
- Erozioni,
- Përmbytja,
- Tërmetet etj.

Rreshqitjet

Jane faktori kryesor qe duhet te evidentohet ne zonat e luginave lumore. Kjo per aresye te:

- Konfiguracionit te terrenit
- Pjerresise se madhe te shpatit.
- Pranise se mbuleses deluviale
- Pranise se bazamentit me material argjilite e ranore
- Pjerresise se shtresave te ketij bazamenti.

Te rastin e terrenit te projektit tone rreshqitjet jane te pranishme kur behen germime ne pjerresi te medha nen nivelin e tokes. Kjo vlen per germimet per ndertimin e Parkimit nentokesor dhe kerkon marrjen e masave inxhinierike per mbrojtjen e skarpatave pasi ne zona te kufizuara te siperfaqes eshte e pamundur te krijohen skarpata te shtrira per te shmangur rreshqitjet e tyre.

Ne lidhje me kete Rekomandojme perdorimin e masave inxhinierike qe te ruhet ekuilibri i skarpatave gjate punes se zbatimit te projektit.

Nje faktor tjeter qe kerkon zbatimin e masave inxhinierike per mbrojtjen e skarpatave eshte prania e nivelit relativisht te larte te ujrave nentokesore.

Perpara fillimit te germimeve ne konturin e projektuar te germimit kerkohet te ngulen palankola rreth e qark dhe brenda tyre te realizohen germimet. Gjatesia e palankolave duhet te zgjidhet ne varesi te thellesise se nevojshme te germimit. Nese thellesia e germimit eshte e madhe gje qe kerkon perdorimin e palankolave me te gjata se ato qe gjenden ne treg eshte e nevojshme germimi i 2-3 metrave te para me skarpate natyrore te skarpatave dhe palankolat te instalohehn ne planin e germimit te fazes se pare.

Erozioni

